



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranuar - Prilazina Më/Dana		20-08-2021	
Nr./ organit	Numri/Broj	Shtetëse	Vlera
Org.broj		Prilog	Vrednost
01-060/01-601			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor, 2008), dhe të Nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011 dhe të Nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

FTESË

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e -VII- të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **31.08.2021 (e Martë)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit të Shtëpisë së Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e gjashtë e KK-së
2. Informatë (Raport) i punës së Kryetarit të Komunës për periudhën Janar – Qershor 2021
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitise për vitin 2022.

Viti, më 20.08.2021

Kryesuesi i Kuvendit
Naim Pira





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosova



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primiljeno Më/Gon 20-08-2021 vit/год			
Nr./ organit Org.broj	Namuri/Ime	Shtet/cë Prilog	Vlera Vrednost
02-052/01-600			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Vitina

***Informatë (Raport) e punës së Kryetarit të Komunës për periudhën janar –
qershor 2021***

Viti, Gusht 2021

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I

- Hyrje	3
---------------	---

KAPITULLI II

Raportet e Zyrave të Kryetarit

- Njësia e Personelit	4
- Zyra për Barazi Gjinore	5
- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun	5
- Lektor	6
- Zyra Ligjore	7
- Zyra e Avokatit Publik të Komunës	7
- Zyra për Integritet Evropian	8
- Zyra për Riatdhesim	8
- Zyra për Projekte	9

KAPITULLI III

Raportet e Drejtorive

- Drejtoria për Administratë	10
- Drejtoria e Inspeksionit	14
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë	17
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	20
- Drejtoria për Arsim	32
- Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	38
- Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi	41
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	44
- Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit	49
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	51

KAPITULLI I

Hyrje

I nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës!
Të nderuar Këshilltarë!

Jam i nderuar, që sot të ju informoj për punën e organeve komunale për periudhën Janar – Qershor 2021. Në këtë Informatë, janë dhënë detajet e nevojshme të angazhimit tonë për periudhën paraprake gjashtëmujore, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës sonë.

Në këtë vit, ne po e përfundojmë edhe një mandat qeverisës, i cili mandat katërvjeçar ishte përplotë të arritura për Komunën tonë, me shumë projekte jetike për mirëqenien e qytetarëve, projekte këto që realisht Vitinë e kanë kthyer në një komunë krejtësisht tjetër, si në infrastrukturë, shëndetësi, arsim, shërbime publike etj. Me bashkëpunim të ndërsjellët, me mirëkuptim me ju të nderuar këshilltarë komunal, qytetarët e komunës sonë si dhe me angazhimin e gjithë stafit, ne kemi arritë, që në këtë gjashtëmujor të realizojmë me sukses një sërë projektesh që garantojnë një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët.

Informata që po e prezantojmë sot, përfshinë detaje nga këto të arritura dhe suksese të qeverisjes sonë me prioritetet si në vijim:

Më lejoni që të përsëris zotimin tim se, qeveria e udhëhequr nga unë, gjithnjë ishte dhe do të jetë në shërbim të qytetarëve të komunës sonë.

Me qëllim që të arrihet kjo, parimet udhëheqëse të qeverisë komunale kanë qenë, janë dhe do të mbesin:

- Zbatimi i panegociushëm dhe i përpiktë i kornizës ligjore që rregullon punën e qeverisë komunale;
- Transparenca dhe llogaridhënia ndaj qytetarëve;
- Gjithëpërfshirja e parezervë e qytetarëve, këshillave të fshatrave, organizatave dhe grupeve të interesit në çdo hallkë të vendimmarrjes;
- Zotimi, disiplina dhe përgjegjësia e çdo shërbyesi të administratës komunale në ofrimin e shërbimeve efikase për qytetarë;
- Kapitalizimi i potencialit të burimeve njerëzore të komunës tonë, përmes bashkëpunimit dhe koordinimit të hapur me organizatat e të rinjve, grave, personave me nevoja të veçanta, bujqve, artistëve, sportistëve, studentëve, etj;
- Bashkëpunimi i ngushtë dhe partneriteti me donatorë dhe organizata të huaja, me qëllim të realizimit të projekteve investive në komunë;
- Bashkëpunimi parimor me qeverinë qendrore, agjencionet dhe mekanizmat në nivel qendror.

Këshilltarë të nderuar!

Dinamika e deritanishme e punëve të planifikuara, besojmë se do të vazhdoj edhe më tutje, ku çdoherë do të jemi afër qytetarëve për t'i dëgjuar brengat e tyre dhe për t'i marrë me seriozitet kërkesat e tyre, në mënyrë që së bashku të bëjmë një zgjidhje në bazë të kapaciteteve që i kemi në dispozicion.

Në vijim keni aktivitetet e zyrave dhe të drejtorive respektive të Administratës Komunale, e të cilat janë kryer përgjatë periudhës për të cilën po raportojmë:

KAPITULLI II

Njësia e Personelit

Gjatë periudhës kohore janar – qershor 2021, Njësia e Burimeve Njerëzore ka kryer punët në bazë të kompetencave dhe autorizimeve të cilat dalin nga Ligji për Zyrtares Publik, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin e Punës, Ligjin mbi Pagat, Ligjin mbi Administratën shtetërore; si dhe aktet tjera nënligjore: Statuti i Komunës dhe Vendimi mbi organizimin e organeve komunale dhe aktet tjera nënligjore të cilat rregullojnë fushën e marrëdhënies së punës.

Njësia e Burimeve Njerëzore, për pjesën e parë të vitin 2021, në bashkëpunim me kryetarin e komunës, ka hartuar planin e Personelit në bazë të udhëzimeve të cilat janë dhënë nga Ministria e Administratës Publike, departamenti i shërbimit civil si dhe drejtoritë përkatëse, në veçanti me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

Njësia e Burimeve Njerëzore, ka zhvilluar të gjitha procedurat për pozitat lëvizje paralel dhe për zyrtaret publik, të cilat i ka pasur në plan të personelit për pjesën e parë të vitit 2021. Pozitat të cilat i kemi rekrutuar gjatë pjesës së parë të vitit 2021, sipas kërkesave të drejtorive dhe planit të personelit janë:

Drejtoria e Administratës, këto pozita: katër zyrtar të gjendjes civile, një zyrtar për mbështetje administrative teknike të kuvendit komunal dhe një zyrtar i depos, për të cilat pozita është shpallur konkursi publik, lëvizje paralele dhe procedurat e regrutimit është kryer sipas Ligjit për Zyrtares Publik dhe Rregullores për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil.

Drejtoria e Inspekcioni, këto pozita: një Inspektor i mjedisit, një inspektor i ndërtimit dhe një udhëheqës i sektorit të Inspektimëve, për të cilat pozita është shpallur konkursi publik, lëvizje brenda kategorisë, ngritje në detyrë dhe procedurat e regrutimit janë kryer sipas Ligjit për Zyrtares Publik dhe Rregullores për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil.

Drejtoria për Arsim, këto pozita: një sekretar shkolle në “Kuvendin e Lezhës”, një sekretar shkolle “Jonuz Zejnullahu”, një zyrtar i lartë për arsim të mesëm të ulët, për të cilat pozita është shpallur konkursi publik, lëvizje brenda kategorisë dhe procedurat e regrutimit është kryer sipas Ligjit për Zyrtares Publik dhe Rregullores për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, këto pozita: dy zyrtarë për mirëqenie sociale dhe një zyrtar për shërbime sociale, për të cilat pozita është shpallur konkursi publik, lëvizje brenda kategorisë dhe procedurat e regrutimit është kryer sipas Ligjit për Zyrtares Publik dhe Rregullores për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil.

Drejtoria për Financa, këto pozita: një zyrtar për zotimin e mjeteve buxhetore dhe një zyrtar të pasurisë. Këto pozita janë kryer me procedurat e transferit, sipas Ligjit për Zyrtares Publik dhe Rregullores për transferet e zyrtarëve publik.

Drejtoria për Kulturë, këto pozita: një zyrtar për rini, pozita është shpallur me konkurs publik, lëvizje brenda kategorisë dhe procedurat e regrutimit është kryer sipas Ligjit për Zyrtares Publik dhe Rregullores për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil.

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Në kuadër të këtij raporti të punës, Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB), për punën e vet është bazuar kryesisht në Planin vjetor të punës për vitin 2021, i cili Plan ka qenë i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Vitisë dhe nga Komiteti për Auditim të Brendshëm(KAB), në të njëjtën kohë një kopje të miratuar e kemi dërguar Drejtorit të NJQHAB të Ministrisë së Financave në Prishtinë, ndërsa bazë ligjore ka pasur Ligjin Nr.06/L-21 për KBFP, udhëzimet administrative për auditim të brendshëm, doracakun e auditimit të brendshëm, statutin e auditimit të brendshëm, instruksionet lidhur me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.

Sipas Planit vjetor të NJAB-së, për vitin 2021, kanë qenë të planifikuara të kryhen gjithsejtë 5 auditime.

Pikësnyimi kryesor i auditimeve ka qenë kryesisht vlerësimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm të ushtruar nga ana-e drejtorëve të drejtorive komunale lidhur me minimizimin e rreziqeve që kanë pasur të bëjnë me realizimin e objektivave të drejtorive gjegjëse, si dhe respektimin e kërkesave ligjore për të arritur një siguri të arsyeshme mbi respektimin e bazës ligjore gjatë procesit të të hyrave, shpenzimeve, si dhe proceseve të tjera.

Auditimet e kryera për periudhën Janar – Qershor 2021, janë:

1.1 Emërtimi i auditimit:

Auditimi Nr.DSHS-21/01

Tema e auditimit: Zbatimi i procedurave të prokurimit publik, për furnizime me mallra, shërbime dhe punë, për periudhën e Vitit 2020

1.2 Emërtimi i auditimit

Auditimi Nr.21/02, është duke u kryer

Zyra për Barazi Gjinore

Në raport janë prezantuar aktivitetet të cilat pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara përgjatë periudhës janar – qershor 2021, ku prej tyre veçojmë:

- Trajnime dhe tryeza për çështjet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore për implementimin e ligjeve të aplikueshme në funksion të barazisë gjinore (1 trajnim dhe një tryezë, në bashkëpunim me OJQ-të lokale)
- Përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjes “Njih të Drejtat” – prezantimi i të drejtave për trashëgiminë dhe pronën, konform ligjeve në fuqi, gjegjësisht LTK-së.
- Analiza gjinore dhe përgatitja e buxhetimit gjinor në kategoritë ekonomike: paga mëditje dhe subvencione
- Sigurimi i të dhënave statistikore nga këto sfera:
 - zhvillim ekonomik;
 - punësim / mirëqenie sociale;
 - shëndetësi;
 - procesin e vendimmarrjes;
- Dhënia e rekomandimeve në fushën e barazisë gjinore në përgjithësi për aktet normative komunale të aprovuara në KK përgjatë periudhës raportuese (harmonizimi i tyre me ligjet që janë në funksion të barazisë gjinore)
- Ofrimi i rekomandimeve për planifikimin e buxhetit nga perspektiva gjinore për vitin 2022-2024
- Fuqizimi ekonomik i grave (bizneseve per vetpunsim) përmes ndarjes së granteve për zhvillimin e bizneseve (biznese për përpunimin e ushqimit).
- Hartimi i Strategjisë për parandalimin e dhunës në familje dhe plani i veprimit 2019-2023 (në proces të hartimit).
- Bashkëpunimi me Avokatin e Popullit për të pranuar ankesat e qytetarëve të Komunës së Vitisë, për shkelje të të drejtave të njeriut nga institucionet.
- Si dhe aktivitete tjera kontinuele

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Gjatë periudhës janar-qershor 2021, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun e Komunës së Vitisë, ka qenë e angazhuar në informimin sa më objektiv dhe të shpejtë për zhvillimet aktuale të Institucioneve komunale. Gjatë kësaj kohe, ne kemi përcjellë të gjitha aktivitetet e rregullta por edhe të veçanta si dhe ka njoftuar publikun e gjerë për zhvillimet e gjithmbarshme në komunën e Vitisë. Gjitha këto ngjarje, janë pasqyruar dhe

publikuar në ueb faqen e komunës kk.rks-gov.net/viti si dhe në adresën e komunës së Vitisë në rrjetin social Facebook.

- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, gjatë kësaj periudhe ka publikuar 40 dokumente mbi procedurat e konkurrimit dhe pranimin në punë si dhe 63 dokumente mbi procedurat e prokurimit publik si: Kontratat e Nënshkruara, Njoftime për Kontratë, Njoftime për dhënie të Kontratës, Planet dhe Raportet e Prokurimit Publik.
- Janë publikuar gjithashtu edhe 52 Njoftime publike, 18 Vendime të Kuvendit Komunal, 22 Vendime të Kryetarit të Komunës, 9 marrëveshje dhe memorandumet të mirëkuptimit si dhe të gjitha draft dokumentet të cilat janë paraparë të shqyrtohen në Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin Komunal.
- Kemi harmonizuar dhe funksionalizuar ueb faqen në gjuhën serbe.
- Po ashtu janë publikuar edhe disa Plane e Raporte si dhe Dokumentet të cilët ndërlidhën me shpenzimin e parasë publike.
- Një bashkëpunim të ndërsjellët dhe shumë të mirë, kemi pasur me mediat lokale dhe ato qendrore. Përmes adresave elektronike, gjitha mediave të shkruara, elektronike dhe agjencive të lajmeve u janë dërguar lajmet për ngjarjet nga komuna e Vitisë edhe përmes fotografive.
- Zyra për Informim publik ka përcjell gjitha aktivitetet e kryetarit të komunës, apo edhe zyrtarëve të tjerë komunal në terren.
- Pritjen e delegacioneve vendore dhe të huaj në komunën tonë.
- Në kuadër të zyrës janë bërë specifikimet e shpenzimeve për publikime: Shpallje, Konkurse, tenderë, Njoftime etj.
- Ndërkaq në kuadër të punës së Zyrës për Informim Publik, janë pranuar dhe shqyrtuar 8 Kërkesa për Qasje në Dokumentet Publike.
- Zyra për Informim ka marrë pjesë pothuajse në të gjitha trajnimet, punëtorit dhe mbledhjet e ndryshme lidhur me Transparencën komunale dhe ngritjes së vendimmarrjes.
- Janë bërë përgatitjet për mbajtjen e debatit të parë të rregullt të kryetarit të komunës në formë elektronike. Ky debat virtual është mbajtur me datën : 28.06.2021, kurse pyetjet janë pranuar përmes platformës Google Forms.
- Gjithashtu Zyra për Informim ka raportuar mbi fushën e Transparencës dhe Përgjegjshmërisë komunale në raportin e SMPK-së për vitin 2020 dhe atë në formë elektronike në sistemin e ri.

Lektori

Gjatë periudhës kohore Janar – Qershor 2021 kam lekturuar këto dokumente:

1. Informata vjetore e Kryetarit të Komunës me drejtoritë komunale 2020. Raporti i prezantimit i kryetarit; Rregullore për mbrojtjen e fëmijëve; Rregullore për ndryshimin/plotësimin e rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Vitisë, me nr. 01-110/05-183, të datës: 31.03.2021; Rregullore për këshillat e fshatrave 2021; Vendim 26.04.2021 (1); Konkurs publik për drejtor 07.06.2021; propozim vendim për miratimin e statutit të qendrës kryesore të mjekësisë familjare në Viti 09.02.2021; Vendim për ankesë IPKO 2021; Vendimet 25.01.2021 (6); Vendimet, shkurt 2021(4); Vendimet 22.03.2021(6); Vendimet 22.04.2021(5); Vendimet 22.06.2021(4); Vendim për auditim të brendshëm 20.01.2021; Kërkesë Agjensisë së Pyjeve; Kontrata për "Arena Sport"; Marrëveshje e mirëkuptimit dhe e bashkëfinancimit ndërmjet Komunës së Vitisë dhe ambulancave veterinarë "A.V" dhe "FARMAVET-M".
2. Procesverbalet e Kuvendit Komunal, procesverballi XI (2020); I, II, III, IV (2021).

3. Procesverbalet e KPF-së XI (2020), I, II, III, IV, V (2021).
Gjithashtu kam ndihmuar edhe gojarisht zyrtarët sipas ndonjë kërkesë me gojë që më është shtruar dhe kam kryer punë shtesë.

Zyra Ligjore

Bazuar në dispozitat ligjore, neni 74 pika d të statutit të Vitisë Nr.01-013/491, lidhur me dispozitat ligjore neni 46 të vendimit të Kryetarit të Komunës për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës komunale, Zyra Ligjore në kuadër të ushtrimit dhe përgjegjësi, autorizimeve si dhe në funksion të zbatimit të ligjeve dhe akteve me fuqi nënligjore, gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2021 ka bërë një punë cilësore, duke kryer harmonizimin dhe korrigjimin e akteve nënligjore të propozuara nga kryetari i komunës dhe nga drejtorët e drejtorive si dhe hartimin e rregulloreve që janë në kompetencë të komunës sipas ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040.

Zyra Ligjore për 6 muajt e parë të vitit 2021, kontributin e saj e ka dhënë edhe në fushën e interpretimit ligjor për të gjitha nevojat komunale. Në kontest të gjithë kësaj, duhet veçuar kontributin në harmonizimin e këtyre akteve nënligjore normative komunale me ligjet në fuqi si në vijim:

- Propozim vendim për emërimin e bibliotekës komunale me emrin e publicistit "Ramadan Musliu"; Procedurat ligjore për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale; Vendim për aprovimin e qasjes në dokumente publike; Përgjigje në kërkesë për transport publik; Propozim rregullore për mbrojtjen dhe përkujdesin e fëmijëve; Njëmbëdhjetë interpretime ligjore; Dhjetë vendime; Tetë përgjigje në kërkesë; Aktpërcjells mbi raportin e vlerësimit të dëmeve; Propozim vendim për themelimin e vendgjuetisë; Vendim për rregullaritet ligjor për ingjiniera; Vendim për rregullaritet ligjor kompanive; Propozim vendim për këmbimin e pronës komunale; Propozim vendim për autorizimin e kryetarit të komunës; Tetë kontrata për shtande; Vendim për plotësim ndryshimin e Statutit të Qendrës së Mjekësisë Familjare; Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm; Katër marrëveshje bashkëpunimi; Shkresë Agjensisë Pyjore të Kosovës; Kontrate "Arena Sport"; Kërkesë Agjensisë Pyjore të Kosovës; Vendim për formimin e komisionit të vendgjuetisë; Kërkesë për të gjithë zyrat për planin e punës; Vendim për refuzimin e qasjes në dokumente publike; Përgjigje në kërkesë; Marrëveshje bashkëpunimi; Dhjetë vendime mbi lejimin e qasjes në dokumente publike; Marrëveshje bashkëpunimi.

Zyra e Avokatit Publik të Komunës

Avokati publik i Komunës funksionin e vet e kryen në bazë të Kushtetutës dhe Ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës, si dhe në bashkëpunim me të gjitha instancat gjyqësore. Avokati publik i Komunës e përfaqëson Komunën në të gjitha instancat gjyqësore, duke filluar nga Gjykata Themelore e deri në Gjykatën Kushtetuese në kontestet gjyqësore, qofshin ato penale apo civile. Avokati publik përfaqëson Komunën në të gjitha fazat, për të gjitha çështjet kontestuese për të cilat Komuna na paraqitet si palë ndërgjyqësore.

Për kohën tani për të cilën po raportojmë Janar-Qershor 2021, avokati publik i Komunës ka kryer këto punë: Lëndët e regjistruara gjyqësore për kohen për të cilën po raportojmë, të të gjithave procedurave gjyqësore, janë **31 lëndë të regjistruara**; **18** lëndë janë nga procedura civile-në procedurë kontestimore të natyrave të ndryshme; **3** lëndë janë të procedurës jashtkontestimore; **10** lëndë janë të procedurës penale, për të cilat lëndë janë ushtruar kallëzime penale, të cilat sipas detyrës zyrtare i udhëheqë prokurori i shtetit. Prej lëndëve kontestimore në procedurën civile, të cilat në numër janë **18**, ku avokati kundër këtyre lëndëve ka ushtruar **11** përgjigje në padi, kundër paditësve dhe 7 padi. Të gjitha këto lëndë janë duke u zhvilluar në procedurë gjyqësore, ndërsa nga lëndët e bartura nga vitet paraprake, të cilat janë ende në procedurë, prej këtyre lëndëve të bartura për të cilat janë mbajtur shumë seanca gjyqësore me vite në këtë periudhë që tani po raportojmë, janë përfunduar me aktvendim, aktgjykim

të formës së prerë nga Gjykata e Apelit e Republikës së Kosovës dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, me mjete të jashtëzakonshme, me revizion janë përfunduar 5 lëndë në favor të Komunës së Vitisë, ku vlera e tyre është 100.000 mijë €, ndërsa 18 lëndët kontestimore, civile, të cekura më lartë për periudhën tani që po raportojmë janar-qershor për 2021. Këto lëndë janë të gjitha në procedurë gjyqësore, disa janë duke u zhvilluar me mjete juridike të **rregullta**, me ankesë ku kemi ushtruar 6 ankesa. Disa janë në procedurën e përmbarimit, ku kemi 14 prapësime si dhe mjete të **jashtëzakonshme** në instancat më të larta gjyqësore. Ndërsa 10 lëndët penale për veprat penale për uzurpime të pronës komunale-shtetërore, nga neni 332 parag.1 i KPRK-së, që sipas detyrës zyrtare i udhëheq Prokurori i Shtetit. Të gjitha këto janë në procedurën e shqyrtimit gjyqësor, ndërsa lëndët penale të bartura nga vitet paraprake në vitin 2021, për të cilin po raportojmë janë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë, 3 lëndë siç e cekem edhe më lartë. Ndërsa lëndët që i përkasin procedurës jashtkontestimore, që fillojnë me propozim, të cilat kanë të bëjnë me gjetjen - rregullimin e sinorëve - mëxhave tokësore të paluajtshmërive, për kohën që po raportojmë, fatmirësisht nuk kemi.

Sa i përket mjeteve të jashtëzakonshme, Revizioni, Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe propozimi për përsëritjen e procedurës, qoftë në procedurë penale, apo civile, të cilat ushtrohen vetëm kundër aktvendimeve, aktgjykimeve të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, Komuna e Vitisë, për këtë që po raportojmë, ka ushtruar 2 revizione, 1 përgjigje në revizion, për të cilat ende nuk kemi vendime, aktgjykime nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

Meqenëse nëpër gjykatat tona ka shumë lëndë të viteve paraprake, të cilat kërkojnë zgjidhje, ende nuk janë treguar edhe përkundër disa parashtrësive të ushtruar nga avokati i komunës për disa lëndë, të cilat janë me prioritet, por ende nuk kemi ftesa për shqyrtim kryesor.

Avokati publik i komunës, përveç punëve që i kryen në bazë të përsëkrimit të vendit të punës, kryen edhe punë tjera shtesë të cilat i delegohen nga Kryetari i Komunës.

Zyra për Integritet Evropian

Zyra Komunale për Integritet Evropian, zyrtari për integritet evropian gjatë periudhës Janar – Qershor 2021, ka kryer këto aktivitete:

1. Kemi profilizuar Planin Kombëtar për Integritet Evropian 2021 dhe i'u ka rekomanduar Zyrës së Kryetarit të Komunës, Zyrës së Kryesuesit të Kuvendit, drejtorive komunale dhe zyrave ndihmëse të Kryetarit të Komunës, për plotësimin e objektivave që dalin nga Planin Kombëtar për Integritet Evropian 2019.
2. Kemi mbajtur takim njoftues me Zyrën e Kryetarit të Komunës, Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit, drejtoritë komunale dhe zyrat ndihmëse të Kryetarit të Komunës
3. Kemi marrë pjesë në Raportin e parë për financimin publik të OSHC-ve, në Republikën e Kosovës.
4. Kemi marrë pjesë në takimin e Kolegjiut të ZKI-ve, me AKK dhe MAPL-në.
5. Kemi përcjell punimet e takimeve të KPF-së.
6. Kemi përcjell punimet e seancave të Kuvendit të Komunës .
7. Kemi marrë pjesë në komisionin për riintegrim, në bordin e drejtorëve.
8. Kemi udhëhequr me komisionin për hapjen e kutive të ankesave, si dhe një varg aktiviteteve të ndryshme të organizuar nga Kryetari i komunës, dhe drejtoritë përkatëse.

Zyra për Riatdhesim

Gjatë kësaj periudhe kohore janë kryer këto aktivitete:

- Janë riatdhesuar:

Nga Gjermania:

- Me familje: dy familje, njëra me 4 anëtarë (bashkëshortët dhe dy fëmijë, djem) dhe tjetra me 6 anëtarë (bashkëshortët dhe 4 fëmijë, tri vajza dhe një djalë)
 - Pa familje: 7 persona
 - Nga Franca:
 - Me familje - Një çifte bashkëshortor
 - Pa familje -1 person
 - Nga Zvicra:
 - Me familje - S'ka
 - Pa familje - 1 person
 - Nga Shtetet tjera: S'ka
- Gjithsej të riatdhesuar 21 persona

- Ndihmë - Përfitues sipas rregullores 13/2017 janë:
- Një familje me 4 anëtarë (banim përmes qeras 2 herë nga gjashtë muaj)
- Kërkesa 1
 - Përgjigje 1
 - Vërtetim mbi bazën e dëshmive 1
 - Me formular të riatdhesimit janë pajisur 10 persona, kërkesa kryesisht për kompletim të dokumentacionit që iu është kërkuar palëve nga Zyra Komunale e Punësimit.
 - Komisioni Komunal për Riintegrim dhe Riatdhesim ka mbajtur një takim.

VENDIME - vetëm një **VENDIM** për banim përmes qerasë (dy herë nga gjashtë muaj)

- Janë monitoruar rastet që ishin për monitorim në bashkëpunim: ZKKK, ZKK-ja Regjionale dhe Zyra Komunale e Punësimit.
- Bashkëpunim me organizatat si: CRP/K - Programi për të Drejtat Civile në Kosovë, Partners Kosova, AWO-ja (Organizatë që ndihmon të riatdhesuarit nga një regjion i Gjermanisë me seli në Nyrberg).
- Bashkëpunim dhe takime (dy takime pune) me Karitasin Zvicerran, njëri takim me Zyren Komunale të Punësimit dhe tjetri me QPS-programi SUREP (kthimi i qëndrueshëm i personave të riatdhesuar përmes RIINTEGRIMIT socioekonomik).
- Takime pune në MPB.
- Letër drejtoreshës së Karitasit Zvicerran, përmes Kryetarit të Komunës, për mundësinë e një marrëveshjeje bashkëpunimi.

Zyra për Projekte

Bazuar në detyrat e punës nga Zyra e Kryetarit të Komunës dhe kërkesat e Zyrës së Projekteve gjatë periudhës janar- qershor të vitit 2019, kemi punuar në hartimin e projekteve, raporteve të pranimit të tyre dhe mbikëqyrjes së zbatimit të projekteve.

Përveç hartimit të projekteve të lartpërmendura, kemi kryer edhe këto punë, si: Hartimin e detyrave projektuese; Pranimin teknik të hartimit të projekteve të ndryshme; Pranime teknike të projekteve të përfunduara; Komisione të ndryshme për vlerësim Menaxhimi i zbatimit të projekteve; Angazhime tjera shtesë sipas kërkesave të menaxhmentit.

KAPITULLI III

Raportet e Drejtorive

Drejtoria për Administratë

Drejtoria për Administratë kryen shërbime të përgjithshme administrative për organet e administratës dhe ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët e Komunës së Vitisë. Shërbimet e përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera të kësaj drejtorie përfshijnë: Ofrimi i shërbimeve dhe kryerja e punëve administrative mbështetëse për punën e kuvendit të komunës, trupave të kuvendit të komunës dhe këshillit të drejtorëve; Përgatitja e akteve të cilat i nxjerr kryetari i komunës, këshilli i drejtorëve; Harton propozim rregullore, propozim vendime në fushën e administratës; Kujdeset për përkthimin e materialeve të kuvendit, trupave të kuvendit dhe këshillit të drejtorëve, duke respektuar gjuhët zyrtare.

Drejtoria për Administratë, ka realizuar objektivat të cilat dalin nga plani i punës së drejtorisë për vitin 2021. Drejtoria për Administratë ka hartuar planin e veprimit për muajt Korrik dhe Gusht 2021, për arsye të kryerjes së shërbimeve administrative për bashkatdhetarët që vijnë nga bota e jashtme për pushime verore.

Në vazhdim do të paraqesim punën e sektorëve të kësaj drejtorie.

I. Sektori për punë administrative

Sektori për punë administrative ka kryer punët dhe detyrat e punës për nevojat e Kuvendit të Komunës së Vitisë, kryetarit të komunës, këshillit të drejtorëve dhe drejtorit të Drejtorisë për Administratë. Ky sektor ka përgatit ftesat dhe materialet tjera për mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete, Këshillit të Drejtorëve, Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, etj. Kuvendi i Komunës ka mbajtur 5 seanca të rregullta dhe 2 seanca solemne, 0 të jashtëzakonshme, urgjente 0 dhe 0 inauguruese. Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbajtur 5 mbledhje të rregullta; Komiteti për komunitete ka mbajtur 3 mbledhje dhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur 4 mbledhje të rregullta. Kuvendi i komunës ka miratuar 2 rregullore, 1 plotësim-ndryshim të rregullores dhe 24 vendime të ndryshme. Të gjitha këto akte normative të kuvendit janë përgatitë për procedurë për nënshkrim dhe protokolim dhe janë dërguar në Ministrinë për Administrim të Pushtetit Lokal për vlerësim të ligjshmërisë së këtyre akteve. Janë përgatitë 5 procesverbale të seancave të Kuvendit të Komunës, 5 procesverbale të Komitetit për Politikë dhe Financa, 3 procesverbale të Komitetit për Komunitete dhe 4 procesverbale të KKS-së.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Këshilli i Drejtorëve ka mbajtur mbledhje konsultative javore dhe 5 mbledhje të rregullta, ku janë shqyrtuar materialet të ndryshme të cilat janë përcjellë për shqyrtim dhe aprovim në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin Komunal. Për mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve është përgatitë materiali si dhe janë hartuar procesverbale për këto mbledhje. Për nevojat e kryetarit të komunës për këtë periudhë raportuese janë hartuar gjithsejtë 164 dokumente; prej tyre vendime 66, marrëveshje 15, kërkesa dhe shkresa të ndryshme. Vendimet e hartuara janë të natyrave të ndryshme: Propozim vendime për kuvend, të ndarjes së ndihmave financiare, vendime për formimin e komisioneve të ndryshme për pranimin e mallit, vendime për caktimin e menaxherit për mbikëqyrjen e punëve, vendime për pranimin teknik të punëve, etj.

Zyrtari për përkthim ka përkthyer në mënyrë simulante në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, Komitetit për Politikë dhe Financa, Këshillit për Siguri në Bashkësi, Komitetit për Komunitete dhe Këshillin e Drejtorëve. Gjithashtu, ka përkthyer edhe të gjitha materialet të cilat kanë dalë nga mbledhjet e Kuvendit, të KPF-së, KKS-së, Komitetit për Komunitete dhe Këshillit të Drejtorëve.

II. Sektori i gjendjes civile

Në vazhdim po e paraqesim numrin e dokumenteve të lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile për periudhën Janar – Qershor 2021.

Nr.	Përshkrimi i Lëndëve	Totali
1	Ekstrakt Lindje	8665
2	Çertifikata Lindjes	4385
3	Çertifikata martesës	1833
4	Çertifikata e Vdekjes	802
5	Çertifikata Vendbanimi	526
6	Çertifikata e Bashkësisë familjare	1298
7	Çertifikata e Statusit Martesor	531
8	Çertifikata e Shtetësisë	98
9	Vërtetim nga Arkivi	433
10	Vendimet	91
11	Aktvdekjet	120
12	Vërtetim i Mjeteve	50
13	Vizita	24
14	Regjistrimet në LAL të jashtme	158
15	Regjistrimet në LAL të brendshme	09
16	Regjistrimet në LAV (vdekje të jashtme)	21
17	Regjistrimet në LAV (vdekje të brendshme)	121
18	Regjistrimet në LAM të jashtme	58
19	Kurorëzime të reja	196
20	Shkurorëzime	43
21	Humbje Shtetësie	15
22	Fitim shtetësie	10
22	Totali:	19419

Numri i përgjithshëm dokumenteve të lëshuara për periudhën Janar – Qershor 2021, është **19419** dokumente. Procesin e verifikimit për këtë periudhë e kanë kryer 670 qytetarë.

Numri i qytetarëve të cilët janë futur në sistemin e Gjendjes Civile në Komunën tonë është **54902**.

Efikasiteti dhe azhuriteti i punës në Sektorin e Gjendjes Civile kishte me qenë edhe më i madh po të mos ballafaqoheshim me pandeminë e Korona Virusit - KOVID 19, që preku edhe komunën tonë nga data 13.03.2020, ku ne si Administratë jemi dëmtuar në mungesë të kërkesave të qytetarëve për marrje të shërbimeve administrative.

III. Sektori i Zyrës Pritëse dhe Arkivit

Zyra Pritëse dhe Arkivit, në kuadër të aktiviteteve të saj të cilat i ka kryer për këtë periudhë raportuese për vitin 2021, janë si: regjistrimin e të gjitha kërkesave dhe parashtresave, shërbimet postare për organet e administratës komunale, ofrimin e ndihmës juridike qytetarëve për plotësimin e kërkesave dhe regjistrimin e kërkesave në protokoll.

Numri i kërkesave të pranuar në zyrën pritëse është paraqitur në formë tabelore.

Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Vdekurve -L.A.V nga jashtë	20
Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Martuarve -L.A.M nga jashtë	50
Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Vdekurve LAV nga brenda	85
Kërkesë për regjistrim në Librin Amë i të Lindurve - L.A.L nga jashtë	147
Numri i kërkesave në zyrën pritëse si : LAL, LAM dhe LAV	
Gjithsej 298	
Deklaratat e nxjerra pran zyrës pritëse:	
Deklarata për vendqëndrim	00
Deklarata për trashëgimi	111
Deklarata për përkujdesje financiare	49
Deklaratë për regjistrimin të mëvonshëm në LAL	12
Deklarata për regjistrim në LAV	29
Gjithsej 201	
TOTALI: 503	

Lëndët e arkivuara

Drejtoria	Nr. i lëndëve të arkivuara
Drejtoria për Shërbime Publike dhe emergjencë	191
Drejtoria për Administratë	15.814
Drejtoria për Arsim	730
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	90
Drejtoria për Financa Ekonomi, dhe Zhvillim	4308
Drejtoria për Kulturë , Rini dhe Sport	125
Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mjedisit	128
Drejtoria e Inspeksionit	58
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	570
Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër	2768
Kuvendi i Komunës	06
Zyra e Kryetarit	60
Zyra për Komunitete	01
Totali	24849

IV. Sektori i administrimit

Ky sektor përfshinë shërbimet që kanë të bëjnë me mbështetjen logjistike të organeve të administratës dhe atë: Kujdesit për mirëmbajtjen e auto veturave zyrtare të organeve të administratës, sigurimin dhe mirëmbajtjen e objekteve komunale.

Vërejtje: Për punë më efikase dhe menaxhim më të suksesshëm në këtë sektor duhet të bëhet rritja e autoparkut, dhe krijim i hapësirave të nevojshme për punë.

Në vazhdim po i prezantojmë shpenzimet e mirëmbajtjes, karburanteve dhe shpenzime tjera për automjete dhe gjeneratorë për periudhën Janar – Qershor 2021.

Shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve dhe gjeneratorëve për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë për periudhën raportuese janë 9.666,00 euro.

- Administrata.....4390,00€,

- Shëndetësia2931,00€ dhe

- Njësia e zjarrfikësve2345,00€

Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, nxehe qendrore, gjenerator dhe autorizime për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë janë 26156 - litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për automjete, për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë janë: 16090 litra.

- Administrata 6180 litra,

- Shëndetësia5518 litra dhe

- Njësia e zjarrfikës4392 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për nxehe qendrore për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Vitisë janë 9146 litra naftë,

- Administrata9146 litra

- D. Kulturës00.00 litra

- Shëndetësia00.00 litra,

- Njësia e zjarrfikësve 0 litra.

Shpenzimet për derivate të naftës për gjenerator për të gjitha njësit shpenzuese janë: 921 litra.

- Administrata 491 litra,

- Shëndetësia 160 litra,

- Njësia e zjarrfikësve79 litra.

- DKA-ja (shkollat).....190 litra.

Zyra e IT-së ka udhëhequr dhe kontrolluar punën e sistemit të teknologjisë informative me qëllimin e zbatimit të standardeve dhe ofrimin e shërbimit më cilësor, në veçanti:

- Ka zbatuar hardware, Softwerin Kompjuterik dhe të qasjes me internet.

- Mirëmbajtjen e infrastrukturës për internet dhe kyçe sipas nevojave të ndryshme për organet komunale.

Për periudhën janar – qershor 2021

Nr.	Emërtimi	Nr. Intervenimeve	Vërejtje
1	Risetimi password të Domenit	150	
2	Hapja e Userve të Domenit	25	
3	Hapja e Userave të Intranetit	/	
4	Intervenimet në Usera	100	
5	Intervenimet në rrjetin qeveritar	72	
6	Intervenimet në programe	250	
7	Instalimi i programeve të ndryshme aplikative	130	
8	Intervenimet në Gjendjen Civile	150	
9	Intervenimet në Tatimin Pronë	120	
10	Futja e kompjuterëve në Domen	75	
11	Instalimi i software	/	
12	Instalimi i computer hardware devices	00	
13	Rregullimi kablllove të internetit	50	
14	Intervenimet në E-mail	100	
15	Hapja E-mail Zyrtar të reja për zyrtar Komunal	25	
16	Intervenimet në Intranet	1	
17	Monitorimi i Kuvendit përmes Teleprezencës	/	

18	Drejtoria Arsimit	20	
19	Qendra për punë sociale	40	
20	Telefonave VOIP	5	
21	Skanimi kompjuterëve nga viruset	00	
22	Intervenimet në shtëpinë e Kulturës	00	
23	Asistimi në rregullimin e fotokopjeve	250	
24	Përkrahje në takime virtuale e zyrave komunale	30	
	Gjithsej	1593	
1. Mirëmbajtja e Serverit çdo ditë 2. Mirëmbajtja e Intranetit çdo ditë 3. Mirëmbajtja e Webfaqes çdo ditë 4. Mirëmbajtja e Gjendjes Civile çdo ditë 5. Mirëmbajtja e-pasurisë çdo ditë 6. Sistemi për Menaxhimin dhe Arkivimin Elektronik të Dokumenteve çdo ditë			

Zyrtari për pranimin e mallit

- Pranimin dhe regjistrimin e mallrave në Sistemin e menaxhimit të Pasurive (E-Pasuria), ku në të përfshihen materialet shpenzuese si dhe asetet komunale ku vlera e këtyre materialëve është mbi 6290.73€ apo, 40 lëndë.
- Kam plotësuar formularët për kërkesën e furnizimit me material për zyre dhe inventarë, në 70 kërkesa.
- Kam bërë furnizimin me material shpenzuese si dhe inventarë për të gjitha njësitë shpenzuese të Komunës së Vitisë duke e përfshirë Zyrën e Kryetarit dhe të gjitha Drejtoritë tjera dhe komunitetet.
- Kam asistuar në disa paramasa për furnizime me materiale shpenzuese për të gjitha njësitë shpenzuese.
- Kam kryer edhe detyra tjera që më janë besuar nga menaxhmenti i Komunës.

Drejtoria për Inspeksion

Në këtë periudhë të gjashtëmujorit të parë, Drejtoria për inspeksion ka qenë e angazhuar në zbatimin e vendimeve të IKSH-P-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë për zbatimin e masave parandaluese të sëmundjes infektive me COVID-19. Andaj edhe inspektorët kanë qenë të angazhuar 24 orë dhe, i'u kemi përgjigjur të gjitha rasteve të kontroleve në bashkëpunim edhe me stacionin Policor në Viti, dhe në rastet e shkeljeve të këtyre masave kemi aplikuar edhe masa ndëshkimore administrative.

Inspektorët e tregtisë

- 21 procesverbale në aspektin e zbatimit të Ligjit për Nr.03/L-181;
- 20 inspektime në zbatim të masave anti covid. Marrja e masave kryesisht është bërë për tejkalim të orarit të përcaktuar me vendim të Qeverisë;
- 30 kontrole në zbatim të masave higjienike, dezinfektimin e hapësirave afariste, pajisjen e punëtorëve me mjete personale mbrojtëse, masave për distancim social dhe shmangien e kontaktit, hapësirave në mes tavolinave shërbyese, etj;
- 10 kontrole mbi kualitetin, cilësinë, sigurinë e produkteve në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve, së bashku me inspektorët sanitar, ku janë larguar nga qarkullimi dhe asgjësuar sasi e konsiderueshme e mallit të rrezikshëm për jetën dhe shëndetin e konsumatorëve;
- 1 kontroll i përbashkët me Njësitin Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, ku janë shënjestruar, sallonet e masazhit trupor në territorin e komunës;
- Kërkesa mbi pranimin teknik të lokalit në shumë prej 912.50 €;

- 19 kërkesa për pranimë teknike të lokaleve;
- 1 kërkesë për vërtetim;
- 15 procesverbale të komisionit për pranim teknik;
- 3 kërkesa në procedurë të zgjidhjes;
- 2 vërtetime për bizneset;
- 35 vizita tjera në biznese në aspektin e zbatimit të dispozitave të Ligjit Nr:03/L-181, dhe dispozitave tjera mbi peshën dhe njësitë matëse, çmimet e artikujve, shpallja e emërimit, biznesit, kushtet e ushtrimit të veprimtarisë e sidomos pajisje me pranim teknik të lokalit.

Inspektori i veterinarisë

- Inspektimi i vazhdueshëm i thertores në Pozhoran;
- Inspektime të marketeve dhe bizneseve tjera të ushqimeve me prejardhje shtazore;
- Marrje të mostrave në mishore: Pozhoran dhe Viti;
- Marrje të mostrave në Gjylekar, në dele, nën dyshimin e Brucelozes;
- Inspektime në fshatin Verban, Sodovinë, Ramnishtë, Gërmovë, Viti. Këto inspektime janë bërë me anëkesa gojore nga qytetarët që kanë qenë të rrezikuar prej qenve endacak;
- Asgjësimin e deleve në Gjylekar, 5 dele dhe 2 dhi;
- Marrja e mostrave të gjakut për sëmundje infektive në Verban dhe 14 dhive në Viti;
- Marrja e mostrave 24 bletarëve nën dyshimin e sëmundjes e ashtuquajtur Pesta Amerikane;
- Asgjësim të gjedheve, që kanë rezultuar pozitiv në Bruceloz dhe Tuberkuloz, në fshatin Verban e Devaj;
- Inspektim në fshatin Shashare, Goden, ku lopët të cilat kanë ngordhur si pasoj e këputjes së telave të rrymës elektrike;
- Inspektim në fshatin Verboc, së bashku me Policinë, si pasoj e ngordhjes nga helmimet e tre qeneve;
- Inspektim në shpeztari, në disa fshatra, ku ka pasur dyshim nga Gripi i shpezëve H5 N8.

Inspektori i mbrojtjes mjedisit

- Kemi inspektuar rrjetet e kanalizimit kolektiv të ujërave të zeza, ku një pjesë e tyre nuk përfundojnë në gropa septike dhe nuk kanë mbikëqyrje nga kompanitë kompetente;
- Në disa fshatra kemi shpërndarë njoftime publike lidhur me ruajtjen e mjedisit dhe pasojat ligjore për ndotësit e mjedisit;
- Kemi marrë pjesë në aksionin e pastrimit të mjedisit me 22 Prill „Dita e Tokës” dhe 5 Qershorin „Dita e Mjedisit” si dhe, aksionin tremujor për pastrimin e mjedisit nga mbeturinat me moton „Ta Pastrojmë Kosovën”;
- Kemi marrë iniciativë për funksionalizimin e deponive të mbeturinave të ngurta (ndërtimore) dhe janë caktuar tri pika: Binçë, Radivojc dhe pika mes të fshatit Sllatinë e Epërme –Tërstenik;
- Kemi marrë pjesë në Gjykatë për shqyrtimin e lëndëve;
- Shqiptimi i 4 gjobave mandatorë;
- Në këtë periudhë kemi ndërprerë 15 aktivitete ndotëse;
- Largimi i plehërave të kafshëve 8 raste;
- Ndalimi i rrjedhjes të ujërave të zeza në ambient të hapur 3; në Skifteraj, Viti dhe Fshat i ri;
- Konstatim: gjendja mjedisore në territorin e komunës nuk është e kënaqshme sidomos (mbeturinave dhe ujërave të zeza), në lokalitetet ku mungon menaxhimi i mbeturinave përmes kompanisë dhe rrjeta e kanalizimit kolektiv.

Inspektori i komunikacionit

- Kemi menaxhuar furnizimin dhe vendosjen e shenjave të Komunikacionit sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës në tërë territorin e komunës së Vitisë;
- Kemi hartuar 14 procesverbale sipas detyrës zyrtare;
- Kemi lëshuar gjithsejtë 8 (tetë) LEJE për vendosjen e pengesave 2 në Podgorc, 1 në Binçë, 1 në Rr."Mustafë Koka", në Viti, Tërpezë, Kabash etj;
- Kemi hartuar 37 Procesverbale mbi shikimin e Automjetit për transport publik –Taxi;
- Kemi bërë 40 Fletëpagesa për taksa komunale dhe atë 48 mbi shikimin e automjetit në vlerë prej 10€, dhe për Pëlqim mbi kyçjen në rrugë;
- Kemi bërë pranimin teknik të lokaleve së bashku me Ins. E Tregtisë dhe atë Sanitarë.

Inspektorët e ndërtimit

Në bazë të planit dhe programit të punës për këtë periudhë kemi zhvilluar këto aktivitete:

- Me këtë rast kemi hartuar 22 procesverbale lidhur me fillin e punimeve të pa pajisura me dokumente për ndërtim;
- Gjithashtu kemi hartuar 11 Vendime për ndërprerjen e punimeve;
- Kemi përgatitur dhe proceduar për Gjykatë këto lëndë:
 - Për Kundërvajtje = 2
 - Për Vepër penale = 2
 - Lëndë në procedurë = 5
 - Lëndë të përfaqësuara në Gjykatën Komunale = 11
- Kemi realizuar gjithsejtë 35 vizita në teren.

Inspektori i sanitarisë

Nr.	INSPEKTIVE	Shprehur në numra
1	Inspektive të objekteve afariste	215
2	Pranime teknike të lokaleve	21
3	Mbyllje të lokaleve	5
4	Procesverbale	87
5	D>D>D	45
6	Inspektive të ujërave të pijshëm	16
9	Mostra të ushqimeve	14
10	Pëlqime Sanitare	12
11	Aktvendime-vendime	893
12	Kundërvajtje	5 -- 47 nga 35 ---2000 €
16	Asegjësim të artikujve ushqimor	28.500kg
18	Inspektive të objekteve shkollë	4
19	Inspektive të objekteve shëndetsore	6
20	Inspektive të pishinave	2
21	EX-Humime	2
22	Vendime për karantinim	812
23	Vendime për përfundim të karantinimit	37
24	Vendime për raste vdekje	39
25	Monitorime të varrimeve	12

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë gjatë periudhës raportuese Janar – Qershor 2021, ka pasur shumë detyra, obligime dhe përgjegjësi sipas planit të punës, të cilat konsiderojmë se i kemi kryer me sukses. Gjatë kësaj periudhe, ne si komunë jemi ballafaquar edhe me pandeminë COVID-19, edhe pse me kushte të vështirsuara, mirëpo drejtoria jonë ka punuar me kapacitete të plota në ofrimin e shërbimeve komunale.

Sektori i shërbimeve publike

Gjatë periudhës janar – qershor 2021, ky sektor ka pranuar gjithsej 172 kërkesa të natyrave të ndryshme, të cilat i kemi kryer në afatin ligjor. Kemi lëshuar vendime të ndryshme, leje për parkim, vazhdimi i lejeve për auto-taxi dhe ngarkesa për shfrytëzimin e hapësirave publike për vitin 2021, si dhe janë bërë pagesa për shfrytëzimin e hapësirave publike, vendosjen e reklamave etj.

Gjatë kësaj periudhe kemi përcjellë punët e operatorëve të kontraktuar nga komuna, të cilët kanë kryer shërbime për komunën.

Buxheti i drejtorisë së shërbimeve publike dhe emergjencë

DSHPE-ja për 6 mujorin Janar- Qershor 2021, ka pasur buxhetin e aprovuar dhe atë në shumë prej 1.012.104.85, ndërsa është shpenzuar 374643.48 €, në përqindje 34%. Prej të cilit për paga dhe mëditje buxheti i aprovuar është 216,158.06 €, është shpenzuar 110,723.31€, shpenzimi i buxhetit është bërë 51%.

Shpenzimet për komunal

Për shpenzime komunal kemi të aprovuara 127000.00 Euro. Shuma e përgjithshme e shpenzuar për komunal është 52.763.60 Euro, shpenzimi për komunal në përqindje është 41%, për PTK, Eco-Higjiena, Hidromorava, KEDS.

Shpenzimet për mallra dhe shërbime

Për mallra dhe shërbime kemi pasur buxhet të aprovuar 668.946.85€, pra Drejtoria gjithësejtë për mallra dhe shërbime nga mjetet e alokuara ka shpenzuar 211.156.57, gjatë këtij 6 mujori janar-qershor 2021 me përqindje 32%.

-Të hyrat vetanake

Tabela e të hyrave vetanake të planifikuara dhe të realizuara 2017

Nr.	Përshkrimi i të hyrave	Planifikimi vjetor për 2021	Realizimi janar-qershor 2021	Përqindja e realizuar. Janar-Qershor 2021
1	Qiraja	13.548.00 Euro	6903.20 €	
2	Shfrytëzim të hapësirës publike	3600.00	3866.00€	
3	Reklamat	4200.00	3360.00	
4	Taksa për licenca tjera për afarizëm. (leje për autotaksi) dhe shërbime tjera profesionale.	300.00		
5	Parkimi publik	7.700 €	325.00€	
	Gjithsej	29348.00	11424.00	Me përqindje të përgjithshme të realizimit të hyrave vetanake është 39%.

Nga kjo tabelë shihet se realizimi i të hyrave vetanake ka qenë mesatarisht i realizuar nga ai i planifikuar.

Mirëmbajtja verore – dimërore e rrugëve lokale

Kemi përcjell punët operatorit ekonomik SH.P.K “Zuka” për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve si: Pastrimi i rrugëve lokale nga akulli dhe bora, mbushjen e gropave me asfalt nëpër rrugë të asfaltuara, furnizimin me zhavor nëpër rrugët e rendit të katërt, pastrimi i bankinave të rrugëve lokale nga barojat dhe shkurret etj.

Mirëmbajtja e HHP

Mirëmbajtjen e HHP-së, gjatë periudhës raportuese e ka bërë operatori ekonomik Shpk “Arbor Group” nga Kamenica. Janë përcjellë punët për mirëmbajtje dhe pastrim të qytetit dhe HHP-së, në bazë të kontratës dhe paramas.

Me hapësira të hapura publike (HHP), të përfshira në këtë projekt nënkuptohen të gjitha sipërfaqet publike me rendësi për zhvillimin e jetës shoqërore dhe publike në qytetin e Komunën e Vitisë.

Janë mirëmbajtje: parqet, sheshet, shëtitorja Viti-Binçë, shtrat i lumit “Morava”, sipërfaqe gjelbëruese, hapësirat për parkim automjesh, rrugët, trotualet, tregjet, lapidarë, pllakat përkujtimore, varrezat e dëshmorëve dhe varrezat e qytetit të Vitisë. Është bërë edhe krasitja e drunjëve dekorativ në qytet, mbjellja e drunjëve dekorativ, mbjellja e luleve në qytet etj.

Pastrimi i objekteve komunale, shëndetësore dhe arsimore

Me pastrimin e objekteve komunale, shëndetësore dhe arsimore, është marrë operatori ekonomik, “Aroma Plus” shpk, “Krasniqi” shpk, ntp “Beni” nga Prishtina. Të gjitha objektet komunale shëndetësore dhe arsimore janë mirëmbajtje sipas kontratës dhe paramasës. Kompania në fjalë ka punuar me tërë kapacitetet edhe gjatë pandemisë nga virusi COVID-19.

Ndriçimi publik

Ndriçimi publik gjatë vitit 2021 në Viti dhe lokalitetet e komunës sonë, është duke mirëmbajtur nga operatori shpk. ATC COM -Kaçanik, në bazë të kontratës dhe paramasës. Vazhdimisht kemi intervenuar në sanimin dhe eliminimin e defekteve në rrjetit e ndriçimit publik. Kemi diku mbi 12.000 trupa ndriçues në territorin e komunës sonë të cilët mirëmbahen.

Mirëmbajtja e aparateve kundër zjarrit

Me këtë projekt njëvjeçar mirëmbahen aparatet kundër zjarrit për NJPZ, institucionet komunale, arsimore dhe shëndetësore. Servisimi bëhet çdo 6 muaj.

Furnizimi me veshmbathje verore për NJPZSH

Zjarrfikësit janë furnizuar me këpucë verore, pantallona dhe maica për sezonin veror.

Ujësjellësi dhe kanalizimi

Në komunën tonë për mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit, përgjegjëse është kompania regjionale “Hidromorava”, njësi në Viti. Kompania në fjalë, bënë furnizimin me ujë të pijshëm dhe mirëmban kanalizimin, në qytetin e Vitisë, fshatin Drobesh, Ramnishtë, Pozharan, Qifllak dhe Letnicë. Ndërsa, në lokalitet tjera ku rrjetet e ujësjellësve dhe rrjetet e kanalizimeve nuk mirëmbahen nga kompania regjionale “Hidromorava”, njësi në Viti, janë mirëmbajtur nga operatori ekonomik „Vizioni BD” i kontraktuar nga komuna e jonë. Janë përcjell punët e kompanisë për mirëmbajtjen e ujësjellësve dhe kanalizimeve nga ana e drejtorisë dhe gjatë kësaj periudhe raportuese janë bërë 17 intervenime në rregullimin e kanalizimeve dhe ujësjellësve, zhblllokim të kanalizimeve etj. Kemi përcjellë edhe punët e kompanisë për mirëmbajtjen e ujësjellësve dhe kanalizimeve në komunën e Vitisë, të cilët nuk mirëmbahen nga kompania “Hidromorava”, ku për këtë periudhë kohore kemi pasur 49 intervenime në rregullime të kanalizimit dhe ujësjellësit, zhbllokime të kanalizimit etj.

Mbeturinat

- Eco-Higjiena si kompani publiko-private, njësia në Viti, bënë mbledhjen, transportimin e mbeturinave në deponin regjionale në Velekincë të Gjilanit dhe atë nga këto vendbanime të komunës: qyteti i Vitisë, Drobesht, Smirë, Tërpezë, Pozheran, Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Ulët, Radivojc, Fshati Ri, Budrik, Remnik, Ramjan, Beguncë, Kabash, Gërmovë, Sodovinë e Jerlive, Sadovinë e Qerkezëve, Vërban, Ramnishtë, Goshicë, Skifteraj, Terstenik, Podgorc, Stubëll e Epërme, Lubishte, Binqë, Devajë, Qifllak dhe Letnicë.
- Numri i ekonomive familjare që janë në sistemin e grumbullimit të mbeturinave gjatë 6 muajve të 2021, në komunën e Vitisë janë: 3663
- Numri i ekonomive komerciale janë: 414
- Mbeturinat e përziera komunale gjatë kësaj periudhe të raportimit janë: 2846.61 t, duke i'u referuar të dhënave të marra nga Eco- Higjiena.

Deponitë ilegale

- Deponi ilegale janë 10, ndërsa gjatë kësaj periudhe 6 muajve janë pastruar 6 prej tyre. Më poshtë do të pasqyrojmë vende - lokacionet dhe numrin e deponive ilegale.

Nr.	Vendi i deponive	Sasia	Komuna
1	Pozheran	1	Viti
2	Devajë	1	Viti
3	Beguncë	1	Viti
4	Sllatinë e Ulët	2	Viti
	Totali	4	Deponi

Punët me Skipin e komunës

Hapja e kanaleve të ndryshme, largimi i borës nga rruga në disa rrugica të qytetit dhe në disa lokalitete rurale, largimin e mbeturinave inerte, varrosjen e kafshëve të ngordhura, mbyllja e rrugëve malore me kërkesë të Drejtorisë së Bujqësisë, rregullimi i hapësirave publike dhe rregullimi i rrugëve nga gërryerjet erozive. Pra, me skipin e komunës janë kryer punë të ndryshme dhe atë në total 125 orë punë, për këtë periudhë raportuese.

Sektori i emergjencave

- Funksionimi i QOEL, koordinimi i aktiviteteve gjatë kohës së gjendjes emergjente me pandemi që nga marsi 2020.
- Dhënie e lejeve për nevojat e qytetarëve për lëvizje në orë policore.
- Koordinimi i aktiviteteve me reaguesit komunal dhe me nivel regjional.
- Punët e përditshme administrative.

5. Përgatitja e materialeve për vërshime për nivelin qendror (dëmet e mëhershme, gjendja e lumenjëve dhe përrockave, vlersimi i rrezikut, etj).

6. Implementimi i vendimeve të kryetarit të komunës në komisione komunale. Azhurimi i të dhënave dhe dërgimi në AME, Qendra Operative Lokale

Njësia profesionale e zjarrfikjes dhe shpëtimit

NJPZSH në Viti, gjatë kësaj periudhe raportuese i ka kryer me përgjegjësi profesionale të gjitha punët dhe detyrat të cilat me ligje është e obliguar t'i kryej. Edhe gjatë kësaj periudhe të pandemisë, njësitit ka punuar me kapacitete të plota.

- Numri i përgjithshëm i daljeve: 122,
- Zjarre: 77,
- Shërbime: 18,

Raporti dhe Pasqyra totale e kërkesave në DSHMS – Janar Qershor 2021

Lloji i kërkesës	Pranuar	Aprovuar	Refuzuar	Procedurë	Ceduar	Shuma
Kërkesa për ndihma momentale	111	61	2	48	0	9,050.00 €
Kërkesa për ndihme financiare për Covid-19 (Vdekjet)	59	51	0	8	0	24,990.00 €
Kërkesa-shkresa të ndryshme	29	28	1	0	0	
Gjithsej	199	140	3	56	0	

- Intervenime teknike: 7,
- Aksidente rrugore: 5
- Dalje në vërshime :15 në pjesët e ndryshme të Vitisë dhe Kllokotit.

Inspektori i preventivës ndaj zjarrit

- Inspektime në vende ngjarje: 30
- Vendshikimet e zjarreve: 13
- Nr. i propozimit të masave: 101
- Nr. raporteve për Polici dhe Prokurori: 4

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Zyra e Drejtorit të DSHMS-së

Zyra e Drejtorit të DSHMS-së përbëhet nga drejtori, juristi dhe punëtori i administratës. Punët të cilat janë kryer nga stafi i drejtpërdrejtë i drejtorit, janë paraqitur në tabelën si në vijim me të dhënat konkrete të punëve, si ndarja e subvencioneve për ndihmë momentale të cilat janë aprovuar nga komisioni në përbërje të tre anëtarëve, pastaj edhe ato të cilat janë pranuar, të proceduara dhe të aprovuara, si dhe ato që janë refuzuar dhe janë nën pezullim. Drejtoria e DSHMS-së, gjatë periudhës gjashtëmujore është përballur edhe me pandeminë Covid-19. Gjatë kësaj kohe përveç detyrave normale të zyrës, ka pasur qëllim edhe luftimin e pandemisë si dhe, në organizimin me përballje me sfida të cilat janë paraqitur gjatë kësaj periudhe emergjente.

Kërkesat dhe Subvencionet në kuadër të Drejtorisë për periudhën 01.01.2021 deri 30.06.2021:

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare-(QKMF) me 11 Njësitë në territorin e komunës së Vitisë

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ka kryer shërbime që të jetë sa më afër qytetarëve dhe të jetë në shërbim të kërkesave të tyre, duke u munduar që të rregulloj sadopak mirëqenien e tyre si në aspektin shëndetësor ashtu edhe në atë psikosocial.

Komuna e Vitisë ka 46989 banorë. QKMF në Viti, ka filluar punën në vitin 1954. Në fillim kanë qenë 17 punëtorë, 4 mjekë, 10 infermierë dhe 3 punëtorë teknik. Sot, QKMF në Viti ka të punësuar 130 punëtorë, prej tyre 26 mjekë, 86 infermier dhe 18 punëtorë teknik dhe administratë. Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, bëhet ofrimi i shërbimeve mjekësore për qytetarë sipas këtyre kategorive mjekësore:

- Në QKMF në qytetin e Vitisë punohet 24 orë. Të gjitha shërbimet mjekësore familjare, stomatologjike, pediatrike, interne, radiologjike dhe laboratorike kryhen vetëm gjatë ndërrimit të parë të orarit të punës.
- Gjatë këtij 6-mujori kemi pasur me pak shërbime, pasi që numri i vizitave mjekësore është ulur, shkak i situatës me pandeminë COVID-19.
- Qendra e emergjencës punon gjatë 24 orëve për çdo ditë të javës.
- Gjatë këtij gjashtëmujori, puna në QKMF ka qenë me sfida të mëdha për stafin shëndetësor, pasi që vazhdimisht kemi pasur raste të reja të prekura me COVID-19, si dhe mungesa e mjekëve e ka vështirësuar punën në masë të madhe.
- Nga data 26.05.2021 deri me 27.06.2021 nuk kemi pasur raste të reja me virusin Sars Covid 2.

1. **Shërbimet primare:** Mjekësia Familjare, Stomatologjia, Vaksinimi, Emergjencia, Diagnostika (Laboratori dhe Shërbimi Radiologjik).

2. **Shërbimet specialistike:** Pediatria, Gjinekologjia, Shërbimi i sëmundjeve të brendshme (Internisti)



Misioni:

„Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe realizimi i standardeve të cilësisë nga pakoja e standardeve minimale në KPSH, duke ndikuar në rritjen e kënaqshmërisë dhe besueshmërisë së pacienteve në shërbimet tona“

Vizioni:

“Përmirësimi i gjendjes së përgjithshme shëndetësore të popullatës, përmes promovimit të konceptit të mjekësisë familjare, ku synim kryesor do të kemi “pacientin në qendër” të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore”.

Organogrami i QKMF-së në viti



Funksionimi i shërbimeve shëndetësore në Komunën e Vitisë

QMF-të si dhe AMF-të të cilat kanë funksionuar gjatë kësaj periudhe në komunën e Vitisë

- 1.QMF - Pozheran
- 2.QMF - Sllatinë e Epërme
- 3.QMF - Smirë
- 4.QMF - Sodovinë
- 5.AMF - Beguncë
- 6.AMF - Skifteraj
- 8.AMF - Stubëll
- 9.AMF - Tërpezë
- 10.AMF - Letnicë nga muaji prill
11. AMF - Remnik

Gjendja në terren

1. Në Qendrën Mjekësore Familjare në Pozheran, punohet 24 orë pa ndërprerë. Në kuadër të kësaj qendre ofrohen të gjitha shërbimet e mjekësisë familjare, si dhe shërbime stomatologjie, por edhe kryhen analiza të ndryshme laboratorike gjatë ndërrimit të parë, gjithashtu ka funksionuar hapësira e veçantë për COVID-19.
2. Qendra e Mjekësisë Familjare në Sllatinë të Epërme, ofron shërbime infermierike dhe mjeku gjatë gjithë javës në orar të rregullt.
3. Në QMF-në në fshatin Smirë, punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierike.
4. Në QMF-në në fshatin Sadovinë të Jerlive, punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit, me shërbime infermierike.
5. Në AMF-në e Skifterajt, punohet dhe ofrohen shërbime çdo ditë punë nga ana e infermierëve përveç vikendit.
6. Në AMF-në e fshatit Beguncë, ofrohen shërbime infermierike çdo ditë pune përveç vikendit.
7. Në fshatin Tërpezë, shërbimet mjekësore ofrohen çdo ditë pune nga infermieret.
8. Në AMF-në në fshatin Stubëll e Epërme, punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit.
9. Në AMF-në në Letnicë, shërbimet shëndetësore nga infermierja kane filluar në muajin prill, pas një ndërprerje për shkak të situatës me Covid dhe mungesës së stafit.
10. Në AMF-në në fshatin Remnik, punohet çdo ditë përveç ditëve të vikendit.

Shërbimet e ofruara nga QKMF-ja, QMF-ja dhe AMF-të

Shërbimet të cilat u janë ofruar qytetarëve në QKMF, QMF dhe AMF për këtë 6-mujor; janë dhënë: **211082** shërbime. Për më tepër, të gjitha llojet e shërbimeve janë të paraqitura përmes tabelës që i bashkëngjitet këtij raporti. (Shih tabelën).

Mjetet e grumbulluara nga participimi për shërbime shëndetësore janë: **20.423.3 €**.
Numri i vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijë gjatë këtij viti ka arritë në 499 vizita.

Gjithashtu për çdo muaj veç e veç mund të shihet në tabelën e bashkangjitur. (Shih tabelën).

Rastet e testuara për COVID19 në Komunën e Vitisë prej 13.03.2020	
Komuna e Vitisë	Nr.
Testime në komunën e Vitisë	5386
Raste Pozitive	1702
Raste negative	3687
Raste aktive	3
Të vdekur	79

PARTICIPIMI 6 mujor ne QKMF

Muaji		Shuma
1	janar	2,115.70 €
2	shkurt	3,810.90 €
3	mars	3,978.50 €
4	prill	3,176.50 €
5	maj	2,889.10 €
6	qershor	4452.60 €
7	korrik	
8	gusht	
9	shtator	
10	tetor	
11	nëntor	
12	dhjetor	
	Gjithsejt	20,423.3 €

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE "NËNE TEREZE"-VITI

RAPORT GJASHTMUJOR
JANAR - QERSHOR 2021

Repartet	Vizita	Vizita s	Vizita C	Therrje	Infuzion	Transfe	Transf Diag	Lidhëje	Inhalime	Këshilla	Ekg	Nr.Analiz	Ndrrim I K	Dhune fa	Nr.Nxerri	Pagesa	L. Pagesa
Emergjencia	21533	426	186	12240	5578	2588		689				308				4980.5	17644
Mjekësia Familjare 1	7454			2380		1511										2131	7657
Mjekësia Familjare 2	3466					682										714	2752
Mjekësia Familjare 3	3305					616										711	2543
Stomatologjia	1097															123.5	1002
RTG	1175															777	914
Dhoma e Inf Covid																	
Dhoma e Infuzioneve			2422		2692										321		
Laboratori	5885				767												
Pediatri	1415																
Interno	339					16	48					66016				220	547
Ekipa e terenit Caritas		595		296	175					126						2981	4720
Ekipa e terenit QKMF		557		89	407			50			125						
Kontrolla Gjinekologjike	964							26					113			167	386
Vizita per nene dhe femij	499			181		57							75				595
Shërbimi i Vaksinimit	2722									272							557
Inhalime ne QKMF Viti				5489												772	1202
Lidhtorja									228								499
TOTALI	49854	1578	2608	20675	9619	5470	48	1011	1776	228	398	433	66016	188	1	321	13757
NUMRI I VIZITAVE NE AMBULLANTAT E QENDRES KRYESORE TË MJEKËSISË PRIMARE																	
Amb.Smire				18	1			34	8	228							282
Amb.Sadovin	45			141	1			72	10	28						5	211
Amb.Slatin	343			818	113			92		19						146	800
Amb.Pozheran Covid			1119		1115												1139
Amb.Pozheran	16768			6956	4136	2927		711	9		126					4674	1260
Laboratori Pozheran	2395											19941				976	2053
Stomatologjia pozheran	292															130	40
Amb.Tërpez				73	21			35	18	111						7	251
Amb.Gjylekar				59	22			31								5	209
Amb.Beguncë				40	4			78	5	88						6	209
Amb.Remink		83		15	1			1		20							42
Amb.Letnic		120		61				27		56							178
Amb.Stubell	370	286		156				43		62						11	641
TOTALI	20213	489	1119	8337	5414	2927		1124	50	714	126	19941	0		130	5915	18548
GJITHSEJ TOTALI	49854	1578	2608	20675	9619	5470	48	1776	228	398	433	66016	188	1	321	13757	49260
GJITHSEJ SHËRBIME	20213	489	1119	8337	5414	2927		1124	50	714	126	19941			130	5915	18548
GJITHSEJ SHËRBIME 211082	69797	2067	3727	29012	15033	8397	48	2900	278	1112	559	85957	188	1	451		
Raporte Statistike																	
E-mai-Zekerja.mustafa@gmail.com																	
Kordinatori I S.I.SH																	
Zekirja Mustafa																	
Drejtori QKMF																	
Dr.Vjollca Kadolli Halili																	
19672 67808																	

Llojet e shërbimeve shëndetësore në QKMF, QMF dhe AmF

Zhvillimi drejt ngritjes së cilësisë së kujdesit shëndetësor Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

Kemi pasur ngecje në implementim të planit të punës së ZHVP-se këtë vit, për shkak të pandemisë COVID-19.

Menaxhmenti i QKMF-së Viti, është munduar të ngritë kualitetin e shërbimeve shëndetësore përmes trajnimeve të stafit mjekësor dhe infermierëve, përmes seminareve dhe trajnimeve të ndryshme, të cilat janë mbajtur kryesisht në mënyre virtuale, por edhe fizike. Gjithashtu, mjekët tanë kanë qenë pjesë e organizimit të trajnimeve virtuale,,që janë organizuar nga UNDP dhe nga MSh , konkretisht trajnerët nga Gjilani , ku 76 infermierë dhe 13 mjekë janë pjesë e trajnimit mbi menaxhimin e pandemisë. Më 27 shkurt, është shënuar dita botërore në luftën

kundër kancerit, organizuar nga QKMF në Viti.

Është organizuar edhe aktiviteti vjetor për dhurimin vullnetar të gjakut, ku kanë qenë 41 dhurues.

Aktivitete tjera:

- Kemi filluar vitin e ri 2021 me kapacitete të plota të punëtorëve, përfshirë edhe punëtorët e angazhuar përmes kontratës me Caritas Kosova.
- Kemi pasur takime të rregullta të Këshillit Drejtues dhe Këshillit Profesional ku në këto takime janë shqyrtuar dhe janë dhënë propozime të ndryshme lidhur me organizimin e sektorëve të ndryshëm si dhe, është debatuar për cilësinë e shërbimeve shëndetësore në QKMF-Viti.
- Takime të rregullta të menaxhmentit me DSHMS dhe institucionet komunale.
- Transporti i rregullt i pacientëve me hemodializë, në spitalin rajonal të Gjilanit.
- Furnizimi i rregullt me barna nga lista esenciale.
- Jemi përballur me mungesë të terapisë kohë pas kohe, pasi që varemi përmes furnizimit nga MSH prej listës esenciale, megjithatë, jemi munduar që vazhdimisht nevojat t'i plotësojmë me terapi dhe material hargjues, kryesisht përmes kontratës për shërbime dhe mallëra.
- Jemi përballur me mungesë të insulinave, e cila mungesë ka rritur pakënaqësin e pacientëve ndaj shërbimeve shëndetësore.
- Në muajin qershor është bërë hapja e AMF - Tërpezë.
- Kemi pasur vizita monitoruese, nga Ministria e Shëndetësisë dhe IKSHP-së.
- Kemi bërë raportimin e rregullt të sëmundjeve ngjitëse, në IRSHP-në Gjilan
- Kemi raportuar në IKSHP dhe MSH në Prishtinë, për ecurinë e vaksinimit, ku vaksinimi është realizuar në shkallë të kënaqshme. Jemi furnizuar me 4938 vakcina anticovid.
- Kujdestaritë janë paguar me rregull në bashkëpunim me DSHMS-së.
- Kemi bërë mbikëqyrjen e participimit, mirëpo kemi ulj të participimit dhe bashkëpagesave, pasi që bazuar në Ligjin për Pandeminë janë pezulluar participimi për pacientët e dyshuar dhe ata të konfirmuar me COVID-19, si dhe kategoritë e liruar sipas Ligjit të Shëndetësisë
- Kemi pasur takime të rregullta me KFOR-in Amerikan (Regjioni i Jugut KFOR LMT 20), si dhe organizatat e tjera të huaja që veprojnë në Kosovë.
- Kemi furnizuar të gjitha ekipet e urgjencës në QKMF - Viti dhe QMF – Pozheran, me çanta për teren, pajisje mjekësore.
- Janë furnizuar me pajisje mjekësore, reparti i gjinekologjisë dhe stomatologjisë.
- Mungesa e një personi të kualifikuar - apo specializuar, në programet kompjuterike të SISH-it dhe programeve tjera.
- Problem tjetër që ndikon shumë në cilësinë e shërbimeve shëndetësore, është marrja e shërbimeve shëndetësore nga pacientët që vijnë nga ordinancat private si shërbimet laboratorike, radiologjike, ekg., infuzione, ampula etj. të cilat na rëndojnë situatën (mbetet kjo problematik të shqyrtohet në nivel qëndror dhe nga DSHMS-ja).
- Problem në vete, është mungesa e listave të pacientëve – klientëve sipas zoonimit.

- Mosfunksionimi i barnatoreve private për të kujdestaruar për çdo natë (ku pas orës 24.00 nuk ka asnjë barnatore hapur në territorin e komunës së Vitisë).
- Staf i pa mjaftueshëm për punë efikase dhe cilësore.

Investimet Kapitale në QKMF

Investimet në QKMF, QMF dhe AMF për 6 mujorin e parë:

1. Përrurimi Ambulantës së fshatit Tërpezë.
2. Vendosja e rrethojave në QMF në Sllatinë të Epërme.
3. Rregullimi i nxehjes me rrymë në QMF, Sadovinë e Jerlive, Sllatinë e Epërme, Smirë edhe në AMF Beguncë dhe Remnik.
4. Janë blere pajisje mjekësore, për mjete të ekipit të urgjencës në QKMF 5 dhe 5 tjera për ekipet e urgjencës në QMF Pozheran. Gjithashtu, janë blerë pajisje për stomatologji dhe gjinekologji. Këto pajisje përfshijnë 10 çanta për terren, stetoskopa me manzheta, otoskopa, ambu-balona, qafore, termometra, aparate të glikemisë, peshore me metër, sete për kirurgji të vogël, sete për gjinekologji, sete për stomatologji etj.
5. Zhvillimi i procedurave të tenderimit, në përfundim e sipër, për renovimin e QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve.

Shërbimet e ofruara për 6 - mujor në QKMF-ë

- Shërbime shëndetësore: 211082.
- Vizita për nëna dhe fëmijë: 499.
- Vizita për pacientët kronik në shtëpi: 1152.
- Janë vaksinuar me vaksinën anticovid: 2672 qytetarë.
- Ka vazhduar trajtimi i pacientëve covid positive, në hapësirën e ndarë në QKMF-Viti dhe QMF-Pozheran.

Donacionet

1. Katër dezinfektues me sensor, të vendosur në Pozheran, Sllatinë e Epërme, Sadovinë e Jerlive dhe Smirë.
2. 12 shkurt, QMF në Pozheran furnizohet me autoambulancë nga Ministria e Shëndetësisë.
3. 16 shkurt, një qytetar dhuroi 6 inhalatorë.
4. 12 maj, Ministria e Shëndetësisë, furnizoi QKMF me dy aparate oksigjenformuese.
5. Misioni i Kombeve të Bashkuara, dhuroi 5000 maska për QKMF në Viti.
6. 28 maj, Ambasada Amerikane ka dhuruar 1500 teste rapide dhe një aparaturë.
7. 24 qershor, UNICEF ka dhuruar 30 pako higjienike në kuadër të programit për vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë.

Raport nga Qendra për Punë Sociale Janar –Qershor 2021

Në QPS-Viti, gjatë gjashtëmujorit të parë nga **01.01.2021 - 30. 06. 2021**, punët kanë rrjedh në përputhshmëri me planifikimin dhe rrethanat e shkaktuara nga pandemia Covid 19. Janë përmbushur dhe detyrat shtesë, në kuadër të ofrimit të shërbimeve për kategoritë e rrezikuara, që përfshihen në domenin e punës sociale, siç janë: shpërndarja e kuponëve, futja e të dhënave në bazën e të dhënave për 50 familje për sigurim shëndetësor, nga dy kategoritë, pilot projekt. Numri i punëtorëve të angazhuar në QPS gjatë kësaj kohe është 9 punëtor aktiv. Drejtori QPS-së, udhëheqësi i shërbimit social dhe 3 punëtorë të shërbimit; Udhëheqësi i Shërbimit të asistencës dhe 1 punëtor të shërbimit; 1 punëtor i administratës dhe financave. Gjatë këtij 6 mujori kemi pas kalimin e punëtorit të asistencës Sylë Salihu, nga shërbimi i asistencës në shërbimin social, përmes konkursit të brendshëm. Kishte konkurs edhe për plotësimin e vendit të punës në shërbimin e asistencës, ku kemi vendin e zbrazët që 2 vite, por nuk ka konkurruar askush. Tani në shërbimin e asistencës punohet vetëm me shefin e shërbimit dhe një punëtor. Poashtu, gjatë kësaj kohe është angazhuar dhe një punëtorë praktikante, Vjosa Lutiu, përmes projektit të përbashkët të atëherë MPMS dhe

Universitetit “Hasan Prishtina”, Prishtinë. Duhet theksuar se, gjatë kësaj periudhe është punuar me staf dhe orar të reduktuar, në përputhje me masat e aplikuara nga MSHK shkaku i pandemisë Covid 19.

<i>Kategoritë e shërbimeve sipas rasteve</i>	<i>Raste të reja</i>	<i>Përsëritura</i>	<i>Të bartura nga vitet tjera</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>Vendosja në institucione – Vërejtje</i>
Raporte të çrregulluara bashkëshortore - Besim i fëmijëve	10	0	5	15	
Të mitur në konflikt me Ligjin	22	5	48	75	
Dhuna në familje	22	0	5	27	
Të mitur me sjellje asociale	13	0	5	18	
Fëmijët e keqtrajtuar fizikisht	6	0	7	13	
Kujdestari e fëmijëve	4	0	26	30	
Fëmijët në strehim familjar tek të afërmit	0	0	8	8	Pages 100 euro mujore
Fëmijët e vendosur në familje strehuese	3	0	0	3	1 vitias, 2 komunë tjetër
Adoptimi i fëmijëve	0	0	4	4	
Kontaktimet prind - fëmijë	0	0	10	10	
Keqtrajtimet, ngacmimet seksuale të fëmijëve	0	0	0	0	
Të moshuar pa përkujdesje familjare	2	0	3	5	3-SHPMPF
Të rritur me nevoja të veçanta	0	0	5		Në Shtime 2, në Ferizaj
Fëmijët me nevoja të veçanta	6	0	43	49	2 dhe në Kamenicë 1
Ftesa gjyqësore për të mitur	17	0	0	17	100 euro mujore 2 muaj plus 60 euro
Ftesa gjyqësore për të rritur	14	0	0	14	
Lypës të rrugës	0	0	0	0	
Masat e shqiptuara për të mitur (MSHP)	4	0	0	4	
MOK	2	0	0	2	Organi Kujdestarisë
Qortim	12	0	0	12	
Burg	0	0	0	0	
Vërtetime për nënshtetësi	25	0	0	25	
Vërtetime të zotësisë së veprimit - për armë	121	0	0	121	
Vërtetime të zotësisë së veprimit - për punë	11			11	
Fëmijët në punë të rënda	0	0	0	0	
Ankesa koms.mj.shk.II	0	0	0	0	
Fëmijët e vendosur në institucionet mbrojtëse	0	0	1	1	

Vendosja stre-dhun familje	3	0	0	3	
Regjistrim i mëvonshëm i fëmijëve	3	0	0	3	
Përdorues të narkotikëve	2	0	0	2	
Martesa e parakohshme	2	0	0	2	
Urdhër mbrojtje për viktimat e dhunës në familje	3	0	0	3	
Shërim i detyrueshëm psikiatrik	0	0	0	0	
Kërcënim	2	0	0	2	
Trafikim	1	0	0	1	
Fëmijët e braktisur të posalindur	0	0	1	1	
Raste tjera në nevojë për shërbime	43	0	0	43	
Gjithsej raste të trajtuara dhe shërbimet e ofruara	352	5	164	521	

Shërbimi social

Pasqyra e pagesave nga shërbimi i asistencës gjatë këtij nëntëmuajorë

<i>Nr.</i>	<i>Muaji</i>	<i>Numri familjeve</i>	<i>Pagesa mujore</i>
1.	Janar	501	108042.50 €
2.	Shkurt	508	109662.50 €
3.	Mars	506	109250.00 €
4.	Prill	482	66369.00 €
5.	Maj	486	67162.00 €
6.	Qershor	486	67112.00
Gjithsej	5 muaj	Mesatarja 491 familje mesatarja mujore	527597.00 € në total

Shërbimet e asistencës

Shërbimi i asistencës bazuar në kriteret e përcaktuara nga departamenti i ministrisë ju ka shpërndarë 147 familjeve kupona për material ushqimorë për 6 muaj.

Gjitha rastet e shqyrtuara për Asistencë Sociale

Rastet e shqyrtuara	Gjithsej	Aprovim	Refuzuara
Aplikim për herën e parë	15+3	12+3	3 gjithsej
Riaplikim	316+27	300+26	16+1
Gjithsej	331+30	312+29	19+1

Lëndët e shqyrtuar nga komisioni mjekësor

Të shqyrtuar	Të aprovuara	Të refuzuara
54+4	47+4	7+0

Lëndët e shqyrtuara sipas ankesës

Te trajtuar	Aprovuara	Refuzuara	Gjithsej
Në shkallë të parë	0	2	2
Në shkallë të dytë	5	2	5
Në Gjykatë	0	2 në shqyrtim	2
Gjithsej	3	4	7 në shqyrtim

Kërkesa për subvencione nga DPSF-DSAS

Gjithsej	Të aprovuara	Të referuara
9	0	0

Vërtetime të lëshuar brenda 5 muajve

Me pagesë	Pa pagesë	Gjithsej
180	00	180

Vërtetime për student

Gjithsej	0
----------	---

Propozim pëlqimi për autorizim për tërheqjen e mjeteve

Gjithsej	3
----------	---

Raporti financiar

Të hyrat vetanake financiare nga taksat komunale në QPS:

Të inkasuara	Të dorëzuara	Gjithsej
1.956,00 €	1.956,00 €	1.956,00 €

Sa i përket shpenzimeve në shërbime e mallra, mirëmbajtje, rrymë, komunal, nuk kemi evidencë, gjitha shkojnë përmes financierit të angazhuar në QKMF "Nëna Terezë".

Drejtoria për Arsim

Zhvillimi i procesit mësimor në Komunën e Vitisë zhvillohet që nga çerdhet, parashkollorët, fillor, i mesëm ulët, i mesëm i lartë, si dhe ai i mesëm profesional. Fillimi i procesit mësimor për periudhën e dytë në vitin shkollor 2020/2021, sipas vendimit të MASHT-it nr.01/B-141 të datës 02.12.2020, ka filluar me datë 18.01.2021. Mësimi është zhvilluar sipas rekomandimeve të dhëna nga ana e IKPSH-së dhe MASHT-it me numër të kufizuar të nxënësve për klasë, dhe me orar të shkurtuar, gjë e cila ka qenë sfidë që të zhvillohet normalisht procesi edukativo-mësimor në disa shkolla, për shkak të hapësirës infrastrukturore, por gjithsesi mësimi është zhvilluar sipas skenarit A, me prezencë të nxënësve në shkollë. Ne kemi filluar me kohë me planin e veprimit për aktivizim të shkollave, sa i përket fillimit të mësimi online përmes platformave të ndryshme, sidomos atyre të propozuara nga ana e MASHT-it. Gjatë kësaj periudhe janë përfshirë edhe:

- Ligjërata me nxënës, përcaktimi i orarit mësimor shkollor, raportimet, etj. Ligjërata që në fokus kanë pasur temat për menaxhimin e kohës në izolim, menaxhimin e ankthit, depresionit, stresit etj, nga ana e psikologëve shkollorë;
- Seanca me nxënës me nevoja të veçanta dhe me prindër për shqyrtime dhe ankesa për organizim më të mirë të mësimi;
- Zhvillimi i takimeve online dhe me prezencë fizike, me MASHT-in;
- Trajnime me organizata të ndryshme;
- Mbajtja e kontakteve në mes të DKA-së dhe MASHT-it;
- Raportimet dhe takimet e rregullta me drejtorët e shkollave dhe DKA-në;
- Raportimet e rregullta ndërmjet DKA-MASHT, dhe inspektoratit arsimor;
- Gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore kemi pas edhe përballje me pandeminë Covid 19, dhe ne si DKA kemi marrë masa përkatëse me taskë forcat e shkollave që të zbatohen kriteret për mbrojtje sipas udhëzuesit të IKSHPK së, dhe manualit për zhvillimin e procesit mësimor. Bashkëpunimi nuk ka munguar edhe me Qendrën e Mjekësisë Familjare në Viti, në lidhje me shkëmbimin e informacioneve, që kishin të bëjnë me stafin arsimor dhe nxënësit e infektuar, në mënyrë që të merren masa adekuate të izolimit dhe instruksioneve të tjera sipas nevojës. Të gjitha shkollat kanë qenë të furnizuara me material dezinfektues dhe pamflete udhëzuese. Gjatë kësaj periudhe, kemi pasur të infektuar gjithsej 26 mësimdhënës dhe 16 nxënës në total.

1. Mbarëvajtja e mësimi në periudhën e dytë dhe të tretë

- Periudha e dytë e vitit shkollor ka mbaruar me datë 02.02.2021 dhe periudha tretë ka filluar me 12.04.2021, ku mësimi ka filluar sipas dy skenarëve në nivel vendi; klasat parafilllore deri në klasën e V, zhvillojnë mësimet sipas skenarit A, me prani fizike, ndërsa klasa e VI-XII zhvillohet sipas skenarit C, pra mësim online, që gjatë kësaj periudhe ka zgjatur vetëm një javë, pra më 19.04.2021, ka filluar mësimi sipas skenarit A, me prezencë fizike për të gjithë;
- Periudha e III ka filluar me datë 12.04.2021 sipas vendimit të MASHT-it për ndryshimin e kalendarit të vitit shkollor 2020/21 në arsimin parauniversitar, me nr.01/B/02 të datës 31.03.2021;
- Ditët e humbura të mësimi në periudhën e I-rë dhe të II të sipas vendimit të lartëpërmendur do të zëvendësohen me ditë mësimi: 5 ditë mësimi në fund të periudhës së tretë, ndërsa dy ditë të tjera u takon komunave të përcaktojnë ditët e shtuna për mbajtjen e mësimi zëvendësues;

- Janë kontrolluar të gjitha shkollat në aspektin profesional pedagogjik si dhe i gjithë dokumentacioni i nevojshëm;
- DKA-ja ka bërë parapërgatitjet për Testin e Arritshmërisë për klasat e IX-ta dhe për Testin e Maturës Shtetërore për klasat e XII;
- Kemi dërguar në MASHT, shënimet statistikore përmes Sistemit të SMIA-së, për numrin e nxënësve sipas paraleleve në secilën shkollë, numri i personelit arsimor etj;
- DKA-ja, ka shtuar aktivitetet për ngritjen e interesimit të nxënësve për testet e Arritshmërisë dhe Maturës Shtetërore, duke i njoftuar nxënësit për mënyrën e plotësimit të testit, për fushat e dijes në cilat ata do të testohen etj;
- Po ashtu arsimtarët e fushave të ndryshme, me qëllim të ngritjes së tyre profesionale kanë marrë pjesë në trajnime ,seminare, debate etj;
- Janë mbajtur debate, konsulta për tema të ndryshme rreth dukurive negative të nxënësve nëpër shkolla;
- Në mënyrë të rregullt kemi përcjellë procesin edukativo-arsimor;
- Është bërë dezinfektimi i të gjitha objekteve shkollore;
- Gjatë kësaj periudhe është kryer edhe vaksinimi i maturanëve;
- Organizimi i Testit të Arritshmërisë për klasat e IX dhe Testit Kombëtar për klasat e XII është organizuar dhe mbajtur sipas vendimit të MASHT-it, konform situatës pandemike si në vijim:
 - ✓ Testi i Arritshmërisë më datë 28.05.2021, me pjesëmarrje të 670 nxënësve dhe e mbajtur në katër qendra shkollore; 3 në viti dhe 1 në fshatin Pozheran. Arritshmëria për 100 pikë ka tejkaluar mesataren aritmetike e 65 pikëve për nxënë;
 - ✓ Testi Kombëtar i Maturës është mbajtur më 26 qershor 2021, me pjesëmarrje të 484 prej 509 maturanëve dhe kalueshmëria ishte 65.50%. Testin e kaluan 317 nxënës , dështuan 167, janë larguar nga testi 3 dhe 22 kanë munguar.

2. Përfundimi i vitit shkollor

- Komuna e Vitisë me gjithsejt 17 shkolla fillore të mesme të ulëta si dhe 18 paralele të ndara, 3 shkolla të mesme të larta e dy çerdhe për fëmijë, (njëra private), ka gjithsejtë 7800 nxënës, duke përfshirë këtu edhe çerdhet (shih tabelen nr 1 dhe 2).
- Viti shkollor 2020/21 apo gjysmëvjetori dytë, periudha e tretë është përfunduar në të gjitha shkollat me data të parapara nga kalendari i rivlerësuar i MASHT-i sipas vendimit nr.01B/51 me 15.06 2021, për ndryshimin e kalendarit të vitit shkollor 2020/21 në arsimin parauniversitar.
- Klasat 0, 1- 8, përfundojnë mësimin me 2 korrik 2021
- Klasat IX-X dhe XI përfunduan mësimin me 21 qershor 2021
- Klasa e XII përfunduan më 02 qershor 2021
- Mësimi plotësues sipas vendimit të MASHT-it ka filluar me datë 05.05.2021, në të gjitha shkollat e komunës së Vitisë, aty ku është paraqitur nevoja për mësim shtesë në mësimnxënie.

Shkolla	vendi	Parashkollor	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 3	Klasa 4	Klasa 5	Klasa 6	Klasa 7	Klasa 8	Klasa 9	Gjithsej
Hysen Terpeza	Terpezë	19	21	15	15	20	20	21	26	21	24	202
Kenan Halimi	Gjylekarë	16	35	27	18	21	24	18	29	23	35	246
Ahmet Hajdari	Beguncë	7	15	6	13	14	14	12	14	18	22	135
Dëshmorët e Lubishtës	Lubisht	20	24	16	14	16	23	22	18	20	12	185
Dëshmorët e Lubishtës I 1	Buzovik	0	5	6	9	9	7	6	14	8	4	68
Dëshmorët e Lubishtës I 2	Podgorc	0	3	2	7	2	0	0	0	0	0	14
Njazi Rexhepi	Sllatinë e epë	30	20	15	21	20	23	32	24	29	39	253
Njazi Rexhepi I 1		0	14	15	18	10	13	9	10	13	11	113
Njazi Rexhepi I 2		19	13	10	17	9	17	16	12	16	18	147
Njazi Rexhepi I 3		10	9	16	14	14	13	0	0	0	0	76
Njazi Rexhepi I 4		10	4	12	9	8	16	23	10	19	19	130
Ndre Mjeda	Kabash	0	24	27	24	18	33	32	47	21	42	268
Ndre Mjeda I 1	Debuldeh	0	0	1	2	2	2	1	0	3	4	15
Ndre Mjeda I 2	Binq	0	2	3	3	0	0	0	0	0	0	8
Dëshmorët e 5 Prillit	Smirë	36	38	31	37	43	25	44	43	36	52	385
Don Mikel Tarabulluzi	Stubbëll	7	6	10	8	6	14	13	9	15	8	96
Don Mikel Tarabulluzi I 1	Letnicë	0	5	0	5	3	0	0	0	0	0	13
Safet Rexhepi	Zhiti	10	12	4	11	10	0	4	8	6	7	72
Safet Rexhepi I 1	Ballanc	0	0	11	5	11	9	6	5	9	11	67
Skender Emerllahu	Ramjan	10	17	11	12	19	10	25	14	20	24	162
Skender Emerllahu I 1	Novosellë	10	14	10	5	0	22	0	0	0	0	61
Bakti Hashiu	Viti	45	74	49	69	70	90	66	70	80	72	685
Bakti Hashiu I 1	Ramnishë	12	22	13	19	23	20	11	14	8	24	165
Nazmi Pajaziti	Radivoje	20	23	18	26	17	15	21	21	16	25	202
Nazmi Pajaziti I 1	Budrikë	10	12	11	6	7	10	10	8	10	6	90
Nazmi Pajaziti I 2	Devajë	0	0	4	2	2	2	0	0	0	0	10
Hasan Alia	Remnik	22	16	25	22	10	20	10	22	16	12	175
Mirali Sejdiu	Goshic	10	8	8	13	11	10	9	13	13	16	111
Mirali Sejdiu I 1	Gërmovë	10	10	5	16	16	13	6	9	8	10	103
Halil Alidema	Pozheran	37	50	35	60	47	43	43	44	41	64	464
Dëshmorët e Vitis	Viti	33	59	56	48	48	48	101	103	73	79	648
Dëshmorët e Vitis I 1	Drobesh	18	27	30	20	32	29	0	0	0	0	156
28 Nëntori	Vërban	22	22	26	27	28	25	28	14	32	33	257
28 Nëntori I 1	Sodovinë e je	10	10	20	17	16	2	22	18	16	25	161
Gjithsej		453	614	548	611	580	617	611	619	590	698	5941

Tabela 1. Numri i nxënësve në SHMU-të në komunën e Vitisë, sipas shkollave.

SHKOLLA	Drejtimi	Vendi	Numri i nxënësve			Gjithsej
Kuvendi i Lezhës	Gjimnazi	Viti	Klasa 10	Klasa 11	Klasa 12	
"Jonuz Zejnullahu"	Profesionale	Viti	315	309	326	950
Kongresi i Manastirit	Mikse (Gjimnaz, Profesionale)	Pozheran	165	188	185	538
			75	61	91	227
			555	558	602	1715

Tabela 2. Numri i nxënësve në SHML-të e komunës së Vitisë, sipas shkollave.

3. Aktivitetet në shkolla të ndryshme gjatë periudhës janar-qershor 2021

Lloji i aktivitetit	Shkolla	Vërejtje
1 Garë e shahut, e organizuar nga pedagogët e edukatës fizike në shkollat e komunës së Vitisë.	Pjesëmarrëse 8 shkolla të komunës së Vitisë.	Garë sportive në shah 30.1.2021
2 Garat regjionale të shahut, në Gjilan	Pjesëmarrës disa shkolla të Vitisë	08.02.2021
3 Garat Komunale në Basketboll-organizuar nga pedagogët e kulturës fizike -	10 shkolla pjesëmarrëse të komunës së Vitisë.	11.03.2021
4 Garat regjionale në Basketboll në Gjilan-Vendi i II-të	Shkolla fituese Sh.f.m.u “ Halil Alidema”Pozheran	18.03.2021
5 Është organizuar “Dita e tokës” për pastrimin e ambientit e sidomos oborreve shkollore, nën patronatin Komunës së Vitisë	Pjesëmarrëse të gjitha shkollat.	22.04 .2021
6 Garë në ping-pong në nivel komunal për nxënësit e Sh.F.M.U- ve dhe atyre të mesme.	11 shkolla pjesëmarrëse	11.02 2021.
7 Garë në Volejbol për Sh.F.M.U-të dhe ato të mesme.	12 shkolla pjesëmarrëse	03.05.2021
8 Gara në Futboll për Sh.F.M.U- të dhe ato të mesme	22 shkolla pjesëmarrëse	22.05.2021
9 Olimpiada Matematike Komunale	Shkollat fillore dhe të mesme	22.02.2021
10 Olimpiada Matematike e Kosovës OMK-2021- Prishtinë	Pjesëmarrës 6 nxënësit fitues të garës komunale.	27.02.2021
Shoqata e Matematikanëve te Kosovës		
11 Vendi i katërt për nivelin 1-5 në nivel republikan në garat e Robotikës KML. Prishtinë.	Shkolla fituese Sh.f.m.u “Njazi Rexhepi” Trestenik	27 .05.2021
12 Dita ndërkombëtare e femijëve u shënua në forma të ndryshme nëpër shkolla.	Në tërë shkollat e komunës së Vitisë.	0.1.06.2021
13 Ligjëratë mbi dhunën në familje dhe ndaj fëmijëve në bashkëpunim me Policinë e Kosovës.	Sh.f.m.u “Halil Alidema” Pozheran	02.06.2021
14 Vendi i dytë në R.Kosovës, në garën e zhvilluar në mes të 40 ekipeve të shkollave të mesme, implementuar nga Ministria e Ekonomisë, në projektin “Krijimi i Qendrave Kreative”, ku ekipi i nxënësve të shkollës tonë garoi me projektin “Qyteti i gjelbërt”, në fushën e elektronikës.	Shkolla e Mesme Profesionale “Jonuz Zejnullahu” Viti	01.06.2021
15 “Festa e Abetares” në shtëpinë e Kulturës	Sh.f.m.u “Bafti Haxhiu” Viti	30.06.2021

4. Shërbimi psikologjik

- Është bërë evidentimi i rasteve (nxënësve), të cilët kanë nevojë për shërbime psikologjike;

- Vazhdim i psikoedukimit me nxënës, duke përfshirë fusha të ndryshme;
- Administrimi i testeve psikologjike, (vlerësimi psiko-fizik për klasën e parë);
- Mbajtja e seancave psikoterapeutike. Nxënësit janë trajtuar me: Këshillim psikologjik, teknika biheviore, psikoterapi pozitive, psikoterapi trupore, psikoterapi familjare, etj;
- Punë e vazhdueshme tek klasa e bashkëngjitur me nxënësit me nevoja të veçanta;
- Takime me ekipin për parandalimin dhe braktisjen e shkollës;
- Takime me ekipin për vlerësim pedagogjik të nxënësve;
- Bashkëpunim me QPS-në;
- Vizita nëpër shkolla;
- Prezantim në takime dhe punëtori;
- Takime në MASHT;
- Certifikimi i mësimdhënësve, të cilët kanë përfunduar trajnimin për kurrikulë në vitin shkollor 2020/21;
- Punë dhe bashkëpunim rreth recensimit të librave shkollorë në bashkëpunim me MASHT-in;
- Administrimi i Testit të Maturës për maturanët.

5. Zyra ligjore e DKA-së në Viti (Sekretaria)

Në periudhën janar-qershor janë protokoluar 411 lëndë të natyrave të ndryshme: Për këtë periudhë kohore prej datës 01.01.2021 deri më 30.06.2021 janë kryer këto punë dhe shërbime: Konkurse-06, Vendime -79, Përgjigje në padi -134, Ankesa drejtuar DKA-së- 1, Ankesa për gjykatën e apelit -02, Kërkesa nga organet e tjera- 106, Përgjigje në kërkesa-23, Pëlqime-09, Njoftime të ndryshme -26, Vërtetime -21, Urdhëresa – 02, Autorizime -2.

6. Sektori i financave

- Brenda kësaj kohe kemi kryer obligimet nga viti 2020, në vlerë prej 4940 €;
- Të gjitha shkollat me kohë janë furnizuar me material higjienik, material harxhues, material pune për zyra, etj;
- Poashtu në këtë sektorë, janë bërë edhe ndryshime në regjistrat e pagave si: futja e punëtorëve të rinjë në listat e pagave, ndërrimet e llogarive bankare për punëtorët, etj, që në total janë 206;
- Furnizimi i shkollave me material mbrojtës anti covid;
- Kemi bërë përgatitjen dhe shpalljen e tenderit, për furnizim me lënde djegëse (dru), për vitin shkollor 2021/22;
- Kemi përgatitur dhe shpallur tenderët për furnizim me material higjienik, furnizim me perde dhe tepisonë, furnizim me pajisje të imëta, furnizimi me internet, etj;
- Po ashtu në sektorin e financave është bërë edhe zotimi i mjeteve për komplet organizatën buxhetore ku janë zotuar 433 pagesa;
- Është përgatitur korniza afat-mesme buxhetore, për vitet 2022-2024.

7. Donacionet

	Donacioni	Shkollat përfituese	Data
1	45 Ipad nga UNICEF-i, në bashkëpunim me MASHT-in	Në të gjitha shkollat për nxënësit me nevoja të veçanta	Janar 2021
2	15 kompjuterë nga Kompania KEDS	SHFMU "Dëshmorët e Vitisë" paralelja në Drobesh	1 Qershor 2021
3	Donacion nga "Karitasi Zvicerian" me participim të komunës me 30%, në renovimin dhe mobilimin e klasave parashkollore në tri shkolla.	SHFMU "Hasan Alia" Remnik, "Dëshmorët e Vitisë: paralelja në Drobesh dhe "Nijazi Rexhepi", Paralelja në Sllatinë	29 prill 2021
4	Nga fondacioni Kosovë-Luksemburg -janë dhënë donacion 40 vitrina për nxënës dhe mjete tjera konkretizuese për laborator.	SHFMU "Dëshmorët e 5 prillit" Smirë	26.04.2021

8. Investime kapitale

- Intervenimi për renovim në disa shkolla, si p.sh.: tek SHFMU "Ahmet Hajdari" Beguncë, vendosja e pllakave tek lavabot e klasave;
- Përrurimi i objektit të shkollës "Dëshmorët e Vitisë", paralelja e ndarë në Drobesh, më 18 janar 2021;
- Rregullimi i tribunave në SHFMU "Njazi"Rexhepi", në Sadovinë të Çerkezëve dhe paralelen e ndarë në Tërstenik;
- Rregullimi i rrethojës së fushës sportive në SHFMU "Bafti Haxhiu", në Viti;
- Rregullimi i disa dritareve të kuzhinës në çerdhen "Gëzimi ynë", në Viti;
- Mbjellja e drunjëve dekorativ në oborin e SHFMU "28 nëntori", në Vërban, dhe rregullimi i tribunës sportive (ulëseve të spektatorëve);
- Rrethoja e fushës sportive në SHFMU "Safet Rexhepi", paralelja e ndarë në Ballancë;
- Ngjyrosja e Hallës Sportive e Shkollës Profesionale "Jonuz Zejnullahu", në Viti;
- Rregullimi i toaleteve në SHFMU "Mirali Sejdiu", paralelja e ndarë në Gërmovë dhe intervenimet tjera në Goshicë;
- Tribuna sportive edhe në SHFMU "Dëshmorët e Lubishtës", në Lubishtë;
- Fillimi i rrethimit të oborrit të SHFMU "Kenan Halimi", në Skifteraj;
- Fillimi i punimeve të fushës sportive në SHFMU "Don Mikel Tarabulluzi", Stubëll;
- Përfundimi i punimeve në çerdhen "Gëzimi Ynë", në Çifllak;
- Vazhdimi i punimeve në SHFMU "Halil Alidema", në Pozheran.

10. Sfidat e paraqitura

- Sfidë kryesore ka qenë luftimi i pandemisë dhe organizimi i mësimi sipas skenareve.
- Zvogëlimi i numrit të nxënësve.
- Mungesa e pajisjeve teknologjike për zhvillimin teknologjik të nxënësve.
- Sfidë në vete ka qenë zëvendësimi i mësimdhënësve të infektuar për periudhën dy javore, ku shpesh mësimdhënësit janë detyruar që orët e tyre t'i mbajnë online.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Punët dhe aktivitetet e kryera në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për periudhën Janar – Qershor 2021 janë zhvilluar në bazë të programit të punës dhe kërkesave të parashtruara nga qytetarët dhe fermerët në lëmin e prodhimtarisë bujqësore.

Në këtë periudhë raportuese, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i ka kryer të gjitha procedurat për fermerët që kanë të bëjnë më: plotësimin e aplikacioneve, dhënien e këshillave, në mënyrë që këta fermer të jenë përfitues të mundshëm të subvencioneve dhe granteve të ndarë nga niveli qendror dhe komuna.

Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, gjatë periudhës janar - qershor 2021, ka kryer këto aktivitete të punës, gjithmonë bazuar në planin vjetor të punës, të hartuar për vitin kalendarik janar – dhjetor 2021.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer këto punë:

- Hartimi i planit të punës vjetor për vitin kalendarik 2021,
- Planet e punës mujore,
- Planet e punës gjashtëmujore,
- Raportet mujore të punës,
- Punët rutinë të kryera,
- Seminare dhe takime të ndryshme,
- Hartimi i projekteve,
- Vizita në teren, regjistrime, evidenca, statistika, këshilla etj.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, aktivitetet e saja i kryen përmes 3 sektorëve: Sektori për Bujqësi dhe Blegtori, Sektori për Pylltari dhe Sektori për Zhvillim Rural.

Sektori për Bujqësi dhe Blegtori

Gjatë këtij viti janë bërë vizita të shumta në teren për grumbullimin e shënimeve në ferma; Është bërë rifreskimi i të dhënave mbi gjendjen në përgjithësi, në të gjithë sektorët e bujqësisë me të dhëna të reja; Hartimi i planeve mujore të vizitave në teren për grumbullimin e shënimeve në ferma; Hartimi i planit të mbjelljeve pranverore për vitin 2021, dhe realizimi i mbjelljeve pranverore; Përcjellja e statistikave bujqësore 54 vizita për vlerësime të dëmit; Kontrollimi i materialit fidanor gjithsej 5; Kontrollimi dhe vizita e bletarëve 18; Kontrollimi dhe vizita në ferma blegtorale gjithsej 10 vizita; Kontrollimi dhe vizita e pemëve të imta gjithsej 10 vizita.

Sektori për Pylltari

- Përgatitja e planit të prerjes;
- Hartimi i planit operativ për mbrojtjen e pyjeve;
- Shqyrtimi i kërkesave për prerje në pyjet private;
- Takime të rregullta me stafin e pylltarisë, realizimi i detyrave të punës;
- Plani Operativ 793.90 m³;
- Gjatë pjesës së parë të vitit 2021 janë mbyllur disa rrugë në pyje me qëllim të pengimit të prerjeve ilegale të pyjeve, ku kanë ndikuar mjaftë në zvogëlimin e dëmeve;
- Gjatë vitit 2021, janë mbajtur disa takime me kryetarin e komunës, komandantin e Stacionit Policor në Viti dhe kryetarin e Gjykatës Themelore - Dega në Viti, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve për ndalimin e prerjeve ilegale;
- Në bashkëpunim me policinë janë realizuar disa kontrolla rutinë në tregje dhe rrugë kyçe që kanë rezultuar me konfiskim të masës drusore të prerë ilegalisht;

- Gjatë periudhës gjashtëmujore nga ana e rojeve të pyllit, janë bërë gjithsejtë 35 fletëparaqitje për dëme në pyje.

Grandet dhe subvencionet nga komuna dhe donatorët:



Fermeri : 8 % 1,200.00 €

Komuna : 20 % 3,120.00 €

IADK : 72 % 11,280.00 €

Vlera e projektit: 15,600.00

Komuna e Vitisë dhe Organizata IKC:




Fermeri : 25 % 35€

Komuna : 75 % 4.200.00 €

IKC : 700 € - 16.68 %

Vlera e projektit: 5425.00 €



Ditën e Çlirimit të Komunës së Vitisë, u hap edhe Panairi i produkteve bujqësore, industriale e artizanale, në sheshin e qytetit “Nijazi Azemi”.



Në Fshatin Sllatinë të Epërme të Vitisë, është hapur fabrika për konservimin dhe përpunimin e perimkulturës “Grasep”. Financuar nga Banka Botërore ARDP .

Të hyrat nga taksat komunale që i përkasin Drejtorisë së Bujqësisë

Duke u bazuar në të hyrat që krijohen nga grumbullimi i taksave komunale nga domeni i bujqësisë paraqitet kjo gjendje;

Të hyrat nga :

- Ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në atë ndërtimore : 2761 €,

Gjithsej të hyra : 2361 €

Shqyrtimi i kërkesave të drejtuara përmes arkivit të komunës

Gjatë këtij gjashtëmujori nga arkivi i komunës kanë arritur gjithsej 43 kërkesa, prej tyre :

Të bartura nga viti paraprak	Të pranuar Janar-Qershor	Gjithsej të pranuar	Të miratuara	Të refuzuara	Gjithsej të shqyrtuara
/	43	43	42	1	43

Kurse, sa i përket kërkesave që i drejtohen drejtorisë pa procedurë të arkivit, numri i tyre është i madh dhe kryesisht kanë të bëjnë me shqyrtimin e mundësisë së subvencionimit të kulturave bujqësore që kultivohen nga ana e tyre.

Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi

Puna dhe objektivat e DKPGJ-së kanë qenë të bazuar në planin e punës për vitin 2021, po ashtu kërkesave të palëve si të personave fizik, ashtu edhe të atyre juridik.

Shërbimet e ofruar nga DKPGJ-ja në vitin 2021 kanë qenë 100% në shërbim të qytetarëve, duke i tejkaluar planifikime. Kjo e bënë që të rritet transparenca në raporte me qytetarin.

Duke u rritur rëndësia e shërbimit më efikas dhe brenda kornizave ligjore po rritet edhe transparenca e DKPGJ-së ndaj qytetarit.

Synimi ynë në 2021 ka qenë shërbimi dhe shqyrtimi i të gjitha lendeve brenda afateve ligjore dhe në mënyrën më të mirë të mundshme, të cilin synim e kemi arritur. Ketë mund ta vëreni edhe në kapitujt e mëposhtëm të këtij raporti.

Vëmendje të veçanta i kemi kushtuar bashkëpunimit me donator dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare, ku vetëm kemi filluar partneritete me ta si: USAID, DEMOSI, WOMEN FOR WOMEN dhe KCBS.

Në raport kemi paraqitur për secilin sektor veç e veç llojet e shërbimeve kryesore që janë kryer, dhe numrin e madh të shërbimeve të ofruar dhe transaksioneve pronësore të regjistruara.

Qëllimi kryesor është që përmes këtij raporti, metodave të aplikuara dhe grafikoneve të paraqitura shkurtimisht, qytetarët të jenë të njoftuar me punën të arriturat, shërbimet dhe sfidat e DKPGJ-se gjatë vitit 2021.

1. Sektorët e DKPGJ-së

Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi, është e rregulluar me një sistemim dhe në bazë të organogramit të brendshëm dhe përshkrimit të detyrave dhe obligimeve të punës të secilit zyrtar, ku aktualisht në këtë drejtori punojnë 9 zyrtar, të cilët janë me kualifikimet e nevojshme për t'i plotësuar nevojat e punës dhe të funksionimit të secilit sektor në drejtori.

Në kuadër të DKPGJ-se ekzistojnë tre sektor:

- Sektori i Kadastrit,
- Sektori i Pronës, dhe
- Sektori i Gjeodezisë.

1.1 Sektori i Kadastrit

Puna në Sektorin e Kadastrit është e bazuar në dispozitat ligjore, të cilat e rregullojnë këtë sektor, i cili është përgjegjës për kujdesin dhe mirëmbajtje të të gjitha regjistrave kadaslral, ku përfshihet e gjithë paluajtshmeria komunale, si dhe regjistri i paluajtshmerive, hipotekave, servituteve digjitale dhe manual, si shërbim kryesor për qytetarët si shërbimi me lëshimin e fletave poseduese, çertifikatave personale dhe sociale.

Gjatë kësaj periudhe në këtë sektor janë kryer këto shërbime kadastrale:

Muaji	Fleta poseduese Me/pa pagës	Certifikata sociale	pi Hipoteka	Transaksione Pronësore
Janar	137 me/0pa	80 copë	-regj/-c'regj	126 lëndë
Shkurt	403 me/4pa	67 copë	2regj/4ç'regj	138 lëndë
Mars	312 me/2 pa	71 copë	4regj/5ç'regj	137 lëndë
Prill	316 me/23pa	65 copë	2regj/4ç'regj	86 lëndë
Maj	239 me/5pa	31 copë	2regj/4ç'regj	85 lëndë
Qershor	192 me/11pa	37 copë	7regj/-ç'regj	100 lëndë
Korrik				
Gusht				
Shtator				
Tetor				
Nëntor				
Dhjetor				
Totali	1.599 me/45 pa	351 copë	17 regj/17 ç'regj	572 lëndë 2.601 lëndë

Tabela nr.1 Shërbimet kadastrale 2021

1.2 Sektori i Pronës

Sektori i pronës ka përgatitë propozim vendime për bordin e drejtoreve dhe Kuvendin Komunal, në lidhje me natyrën e punëve në drejtori. Në vazhdimësi, ka bërë interpretimin e normave ligjore që janë në fuqi, ka kryer punë administrative në drejtori: përpilimin e aktvendimeve, urdhëresave dhe akteve tjera, ka lëshuar vërtetime për pronat që komuna nuk ka interes t'i blejë ato. I ka pranuar kërkesat e drejtuar drejtorisë, i ka shqyrtuar ato dhe ju është përgjigjur me shkrim. Ka zhvilluar procedurat për eksproprijim të tokave në pronësi private, për interesa të përgjithshme publike. Poashtu, për herë të parë është bërë evidentimi i pronës komunale. Ky projekt është përkrahur dhe është realizuar me ndihmën e Demosit sipas zonave Kadastrale. Poashtu, i ka shqyrtuar të gjitha kërkesat e palëve të cilat i janë drejtuar drejtorisë, lidhur me dhënien e pronës në shfrytëzim.

Gjatë vitit 2021 për Kuvendin Komunal janë përgatitur 13 propozim-vendime nga ky sektor.

1.3 Sektori i Gjeodezisë

Sektori i Gjeodezisë, për gjatë vitit ka kryer këto shërbime për palët dhe Komunën, si: Mirëmbajtja e kadastrës digjitale në sistemin kosovare f01; ka përcjellë vektorizimin e raster planeve; ka përgatitë dhe mbikëqyrë të dhënat për kompanitë dhe gjeodetët e licencuar; ka përgatitë raportet ditore për Agjencinë Kadastrale të Kosovës; ka pranuar lëndët e kryera nga kompanitë dhe gjeodetët e licencuar dhe të njëjtat i azhurnon në sistemin zyrtar (Geomedia profesional 5.2); ka bërë azhurnimin e ndarjeve fizike në librat e regjistrimeve të ndarjeve kadastrale; ka bërë hartimin e kopjeve të planit; kontroll të vazhdueshme kualitetit të të dhënave grafike kadastrale dhe atyre tekstuale; projektim të rrjeteve referente, të rendit të tretë të shtruar me GPS; mirëmbajtje për rrjetat referente të rendit të tretë për tërë zonat kadastrale në kuadër të Komunës së Vitisë; identifikim i parcelave në zyrë; futja e të

dhënave grafike në datamodelin zyrtar; konsulta dhe këshilla profesionale në lëminë e Gjeodezisë dhe Kadastrës, për palët e interesuara në kuadër të shërbimeve kadastrale; Ekspertiza kadastrale për nevoja të Gjykatave.

Muaji	Kopjet planit Me pag/pa pag	Pr për kon private	Ndarje/azhu	Bashkim parcelave	Ndërrim kulture
Janar	69/10	20	38ndarje	8bashkim	k11
Shkurt	81/3	26	46ndarje	7bashkime	
Mars	117/21	26	58ndarje	5bashkim/	1 ndërrime
Prill	88/8	21	33ndarje	6 bashkim	1 ndërrime
Maj	77/3	8	15ndarje	4 bashkim	0 ndërrime
Qershor	71/5	25	41 ndarje	8bashkim	1ndërrim
Korrik					
Gusht					
Shtator					
Tetor					
Nëntor					
Dhjetor					
Totali	503/40	126	231	37	3 940 lëndë

Tabela Nr.3 Shërbimet në sektorin e Gjeodezisë

2. Sfidat

2.1 Pengesat të cilat i përcjell këta Sektor janë:

- Mungesa e shënimeve prej vitit 1985 – 1999;
- Lidhjet e dobëta digjitale në bazën e të dhënave dhe shpeshherë ndërprerja e tyre kohë pas kohe me Agjensionin Kadastral të Republikës së Kosovës;
- Mungesa e shënimeve gjeodezike nga viti 1985 – 1999;
- Mungesa e planeve/skicave për zonat kadastrale, të cilat janë pjesë të komasacionit.

2.2 Propozim masat të cilat duhet të merren për efikasitet janë:

- Insistimi i faktorëve institucional, vendor dhe ndërkombëtar tek Institucionet e Serbisë, për kthimin e shënimeve kadastrale dhe gjeodezike, respektivisht planeve gjeodezike;
- Insistimi i institucioneve vendore dhe i mekanizmave ndërkombëtar tek institucionet e Serbisë, për kthimin e dokumentacionit kadastral, të konfiskuar (grabitur gjatë luftës);

- Përpjekjet për përmirësimin e lidhjeve digjitale në bazën e të dhënave me Agjensionin Kadastral të Republikës së Kosovës

3.0. Të hyrat financiare

Gjatë vitit 2021 Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e kanë përcjellur sfida të mëdha lidhur me pandeminë Covid 19, ku si rezultat i saj kemi ulje të mëdha të të hyrave në raport me vitet paraprake.

Planifikimi për janar - qershor për vitin 2021: 80,200.00€

Realizimi për janar - qershor për vitin 2021: 684.866.59€

3.1 Vendim për plotësimin e listës për dhënien në shfrytëzim

3. Propozim -Vendim për shfuqizimin e vendimit për parkingje

4.Propozim -Vendim për dhënen në shfrytëzim të pronës komunale - parkingjet publike.

Përgjigje palëve

Përgjigjet e palëve në kërkesat e tyre për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim: Pas shqyrtimit të kërkesave të palëve, duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, kemi kthyer tetë përgjigje.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në kuadër të kompetencave të saja ka zhvilluar politikat programore të drejtorisë në fushat e caktuara sipas Ligjeve dhe akteve tjera rregullative të nivelit lokal dhe qendror;
- Drejtoria ka implementuar aktivitete e planifikuara sipas planprogrameve të sektorëve përkatës;
- Drejtoria në kuadër të aktiviteteve ka shfrytëzuar dy kodet buxhetore për zhvillim të aktiviteteve:
 - ✓ Kodi buxhetor i shërbimeve dhe mallrave dhe
 - ✓ Kodi buxhetor i subvencioneve.
- Investimet kapitale të drejtorisë lidhen drejtpërdrejt me projektet zhvillimore të komunës, të cilat janë në kuadër të planifikimit të projekteve kapitale;
- Mbështetja e entiteteve publike është bërë përmes dy kodeve buxhetore: kodi buxhetor i subvencioneve dhe kodi buxhetor i shërbimeve dhe mallrave;
- Subvencionimi i entiteteve publike është bërë sipas rregullores **04/2017 MF**, përmes thirrjes publike dhe procedurave tjera të nënshtruara sipas po të njëjtës rregullore **04/2017 MF**
- Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve me OJQ-të lokale;
- Drejtoria ka vazhduar bashkëpunimin me organizatat lokale në implementimin e aktiviteteve, sipas thirrjes publike dhe mbështetjes se OJQ-ve të subvencionuara.
- Drejtoria ka krijuar një bashkëpunim tradicional me KFOR-in Amerikan, në zhvillimin e aktiviteteve në fushat e kulturës dhe sportit.
- Drejtoria ka qenë e përkushtuar në publikimin e aktiviteteve përmes faqeve zyrtare të Facebookut të drejtorisë dhe Komunës.
- Drejtoria në kuadër të aktiviteteve të saja ka qenë e detyruar t'i nënshtrohet rekomandimeve të IKSHPK për masat anti "Covid 19".
- Drejtori me rastin e raportimit të performancës ka arritur kuotën e 100% me reduktimin e fushave në kulturë, ndërsa vetëm me sportin sipas fushave të caktuara janë arritur rezultatet kulminante;

- Drejtoria ka shtypur raportin e performances ne dy ekzemplar te dizajnuar nga aktivitetet e drejtorisë për vitin 2020, të punuar nga përgjegjësi i performancës së drejtorisë.

AKTIVITETET

POLITIKAT PROGRAMORE TË DREJTORISË

- Planifikimi buxhetorë i drejtorisë në dy kategoritë buxhetore
- Planifikimi i investimeve kapitale
- Planifikimi i shërbimeve dhe mallrave
- Thirrja publike për mbështetje të entiteteve publike për subvencione
- Subvencionimi i 11 entiteteve publike me **38,000€**, 50% e mjeteve të transferuara
1. AKV "Kemajl Azizi", 2. Kori i qytetit, 3. QK "Anamorava", 4. KFF "Presingu", 5. K. Pingpongut, 6. Klubi i Gjimnastikës, 7. OJQ "EULOC", 8. IMADNJ, 9. HAC "Angros", 10 KF "Vllaznia" dhe 11. KF "Uniteti".
- Themelimi i komisionit për ndarjen e subvencioneve dhe komisionit të ankesave;
- Kontrata dhe vendimet me OJQ-të përfituese të subvencioneve;
- Monitorimi i OJQ-ve përfituese të subvencioneve;
- Planifikimi i datave zyrtare për organizimin e eventeve komunale dhe shtetërore;
- Bashkëpunimi me organizatat vendore dhe ndërkombëtare;
- Mbështetje e sportistëve me normë individuale anëtar të reprezentacionit dhe KOK Urata Rama, Drilon Ibrahim dhe Lumturie Rama si dhe Agim Agushi - Guinness World Records;
- Mbështetja e turneve në futboll me shërbime dhe mallra;
- Mbështetja e OJQ-ve kulturore.

I. KULTURË

Investimet kapitale në infrastrukturë kulturore

1. Renovimi i objektit për muze komunal në Viti - përrurimi i muzeut me 2 qershor 2021

Aktivitetet kulturore

- *Manifestimi tradicional "Flakadani i Karadakut"- 2021.*
 - ✓ Hapja solemne e manifestimit më 21 mars
 - ✓ Ekspozita me eksponate të Dëshmorit "Nijazi Azemi" – Komandant Mekra
 - ✓ Ora e Madhe Letrare më 23 mars
 - ✓ Festivali gjithëkombëtar 24, 25 dhe 26 mars
- *Shënimi i të gjitha datave me rëndësi kulturore dhe historike të cilat janë në kalendarin zyrtar të Komunës së Vitisë si:*
 - ✓ 17 Shkurti, Dita e Pavarësisë së Kosovës
 - ✓ 5 Maji, Dita e Dëshmorëve të Komunës së Vitisë
 - ✓ 14 Qershori, Dita e Çlirimit të Vitisë etj.

II. Biblioteka publike "Ramadan Musliu"

1. Projekti i financuar nga MKRS furnizim me libra **61 tituj me 340 ekzemplar**;
2. Promovimi dhe emërtimi i Bibliotekës Publike **"Ramadan Musliu"**;
3. MKRS/Biblioteka kombëtare donacion **210 titujve me 262 ekzemplarë**;
4. Pranimi i donacionit dhe **krijimi i këndit të bibliotekës me emrin "Dr.Isak Shema"**
5. Shërbimet bibliotekare në Bibliteken qendrore në Viti për të rritur, fëmijë dhe Bibliotekat amë në Sllatinë të Epërme dhe Pozheran;
6. Shërbimet për lexues/studenta në bibliotekën e të rriturve;
7. **Printeri 3D** i fituar nga "Bone vet", në bibloteken e të rriturve

III. SPORT

Investimet kapitale në infrastrukturë sportive - vazhdimi i punës kontinuele të projekteve kapitale:

1. Palestra e sportit në Drobesh;
2. Stadiumi në Vitisë – (përrurimi u bë me 14 qershor – Dita e Çlirimit të Vitisë);
3. Stadiumi "Ibrahim Kurteshi", në Pozheran;
4. Stadiumi ndihmës i KF "Vllaznia", nga Pozherani.

Aktivitetet sportive

- Shpallja e sportistëve - Laureatve të vitit 2020;
- Viti, 17 shkurt 2021 - VRAPIMI I PAVARËSISË SË KOSOVËS;
- Manifestimi sportiv "Flakadani i Karadakut" 2021;
 - ✓ Turneu revyal në futboll të vogël;
 - ✓ Turneu revyal në pingpong;
 - ✓ Turneu revyal në shah;
 - ✓ Shtegtim me motora, sjellja e flakadanit nga Mogilla;
 - ✓ Turneu tradicional në futboll të vogël "Kenan Halimi" në Skifteraj
 - ✓ Turneu tradicional "2 Korriku", Beguncë.

Të arriturat nga Klubet sportive

1. Klubi i Gjimnastikës 17 medalje në kampionatit e Kosovës në Gjimnastikë;
2. Turne i Klubit të Gjimnastikës në Shqipëri, gara në Shkodër dhe performancë në Kavajë;
3. Klubi i Futsallit, kampion i Ligës së Parë, kaloi në Super Ligë;
4. Dy sportist nga Vitia me normë olimpike. Në Lojrat Olimpike udhëtojnë Drilon Ibrahimimi dhe Uratë Rama;
5. Rezultate shumë të mira ka arritë Klubi i Futbollit i Femrave "Presingu".

IV. RINI

Projekte të bashkëpunimit me organizata dhe institucione vendore dhe ndërkombëtare për rini

1. Bashkëpunimi me OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare;
2. 22 prilli – Dita ndërkombëtare e Tokës – Shtegtim me biçikleta ;
3. Caritas Kosova projekti “Jour Job”;
4. Projektin “Up to Youth”, të financuar nga USAID;
5. 1 QERSHORI - DITA NDËRKOMBËTARE E FËMIJËVE
 - Vizitë nga SHFMU "Bafti Haxhiu", kryetarit të komunës z. Sokol Haliti
 - Vizitë nga SHFMU "Bafti Haxhiu", në Viti – Kuvendit të Komunës
 - Vizitë nga SHFMU "Bafti Haxhiu", Gjykatës Themelore në Viti
 - Vizitë nga SHFMU "Bafti Haxhiu", Stacionit Policor në Viti.
 - Koncert festiv me rastin e 1 qershorit - Ditës së fëmijëve, nga OJQ-të lokale dhe shkollat
 - Socializimi i fëmijëve nga SHFMU "Bafti Haxhiu", - Viti (klasa me nevojat e veçanta) dhe SHFMU "28 nëntori", nga Vërbani.

V. ARKIVI HISTORIK KOMUNAL

- Shërbimi i brendshëm
- Shërbimi i jashtëm
- Kërkesat nga palët - 49
- Kërkesa të realizuara - 35
- Kërkesa të pa realizuara – 14
- Taksa të inkasuara – 74€

VI. SHTËPIA E KULTURËS “GURSEL E BAJRAM SYLEJMANI”

- Lëvizje të brendshme, plotësim i vendit të Hetem Kurteshit me Avdirrahman Sadiku (përgjegjës për rini dhe shtëpi të kulturës)
- Pajisja e Shtëpisë së kulturës me kamera dhe lidhja me TV
- Pranimi i punëtorëve me kontrata në vepër (muzeu)
- Pajisja e sallës së koncerteve me zërim
- Pajisja e sallës së Kuvendit Komunal me zërim

Publikimet e aktiviteteve

- Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, aktivitetet e saja i ka publikuar në faqen e rrejtit social Facebook Dkrs.Viti@hotmail.com dhe në faqen zyrtare të Komun së Vitisë.

Bashkëpunimi me organizatat vendore dhe ndërkombëtare

- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka vazhduar bashkëpunimin me organizatat vendore dhe ndërkombëtare por edhe me KFOR-in Amerikan
- Organizata ndërkombëtare që mbështesin projektet rinore siq janë: USAID, Komisioni Evropian projekti i marrëveshjes ndërkufitare, Caritas Kosova, etj.

Shërbimet dhe asktivistet me OJQ-të

- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ka mbështetur OJQ-të nga kodet buxhetore të shërbimeve dhe mallra si me transport dhe shërbimet tjera te zerimit, hapësirave në shtëpinë e kulturës për ushtrime, etj.
-

Raportet i sistemin të menaxhimit të performancës së drejtorisë

- Bazuar në raportin e performancës së drejtorisë vitin për vitin e kaluar në kushte pandemie sipas kriterëve të ministrisë dhe ngrirjes së aktiviteteve kulturore performanca nga aktivitetet sportive u radhiten 100% pë qind.
- Shtypja e raportit të performancës si dëshmi me fotografi ne dy ekzemplar me nga 149 faqe

VII. AKTIVITETET SIPAS REKOMANDIMEVE TË IKSHPK-SË

- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, gjatë zhvillimit të aktiviteteve i është nënshtruar masave anti "Covid 19" sipas rekomandimeve të IKSHPK-së.
- Të gjitha aktivitetet detyrimisht janë zbatuar sipas rekomandimeve por ka aktivitete te cilat jan anuluar per arsye të masave në fuqi që edhe sot kufiojnë aktivitetet.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Ky raport është i bazuar në kërkesat dhe detyrat të cilat jemi të obliguar, që në harmoni me planet e dala nga "Plani Zhvillimor Komunal" Nr.01-013/126, i datës 07.02.2011, "Plani Zhvillimor Urban" me Nr. 01-013/126, i datës 07. 02. 2011; Planet rregulluese: "Zona Qendrore dhe Jugore dhe Lumi", me Nr.01-013/1275, i datës 21.02.2013, si dhe "Zona Veriore", me Nr.01-013/869, i datës 08.10.2013.

Implementimin e kriterëve ndërtimore të dalë nga: "Rregullorja për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve në Komunën e Vitisë", Nr. 01-013/317, të datës 15.03.2011; Kontrollimi i planeve rregulluese detale, të miratuara në raport me kërkesat për ndërtim nga qytetarët; Kërkesa për dhënien e informatave për parcela të ndryshme, se çfarë destinimi kanë me plane zhvillimore komunale dhe urbane; Gjatë periudhës gjashtëmujore të vitit 2021, kjo drejtori ka kryer këto punë dhe aktivitete të përshkruara sipas planit të punës për vitin 2021:

Janë kryer këto punë dhe aktivitete të përshkruara sektor për sektor:

▪ **Sektori i Urbanizmit;**

Gjithsej 53 kërkesa

❖ Kërkesa për pëlqim urbanistik.....	09
• Të miratuara	09
• Të refuzuara	00
• Në proces	00
❖ Kërkesa për Legalizim	41
➤ Të miratuara	28
➤ Në proces	13
❖ Kërkesa për leje ndërtimore	02
• Të miratuara	00
• Të refuzuara	00
• Në proces.....	02
❖ Kërkesa për leje rrënimi	01
➤ Të miratuara	01
➤ Në proces	00

▪ **Sektori i Planifikimit ;**

❖ Është punuar në ekip komunal për vlerësimin e zbatueshmërisë së Dokumenteve të Planifikimit PZHK dhe PZHU-së, dhe përgatitjet për hartimin e HZK.	
❖ Është përfunduar hartimi për Planin Zhvillimor Komunal, dhe janë përfunduar debatet nëpër lokalitete.	
❖ <u>Në sektorin e planifikimit janë shqyrtuar 16 kërkesa të ndryshme</u>	
Kërkesa për dhënie të informatave urbanistike.	
❖ Gjithsejtë kërkesa:	12
➤ Të shqyrtuara :	12
➤ Në proces	00
❖ Vendime për kushte të ndërtimit	04
➤ Vendime për kushte të ndërtimit në proces.....	00

▪ **Sektori i Mjedisit;**

• **Shpallja e vitit 2020 vit i ambientit në komunën e Vitisë, me vendim të kryetarit të komunës së Vitisë z.Sokol Haliti.**

- Gjatë kësaj periudhe janë shënuar ditët e ambientit 01-22 prill 2021;
- Janë mbajtur aktivitete pastrimi në shumicën e lokaliteteve të komunës;
- Është bërë pastrimi i hapësirave të varrezave të të gjitha komuniteteve fetare, në bashkëpunim me KFOR-in Amerikan;
- Janë mbjellë lule dhe drunj dekorativ;
- Është shënuar “Dita Botërore e Mjedisit”, më 05 qershor 2021 në aksion, ku nën masat e parapara nga IKSHPK kanë marrë pjesë mbi 200 pjesëmarrës dhe janë larguar mbi 100 thasë mbeturina, janë mbjell 100 fidane lulesh dhe 30 drunj dekorativ në parkun rreth lumit, përballë shkollave të mesme në qytet;
- Aktivitete të pastrimit të ambientit në bashkëpunim me këshillat e fshatrave, janë shënuar edhe në disa fshatra të Komunës;
- Në vazhdimësi është bërë vlerësimi i gjendjes mjedisore, është bërë grumbullimi i informatave nga terreni lidhur me çështjet mjedisore, të cilat janë në një Raport të Zgjeruar Mbi Gjendjen e Mjedisit në Komunën e Vitisë;
- Është në proces **Leja Mjedisore Komunale** për veprimtari.

Zyra e Adresave;

- Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit në mes Zyrës së Adresave të komunës së Vitisë, Agjencionit Kadastral dhe shtetit Norvegjez, ku jemi përfitues të donacionit në vlerë mbi 15.000€, i cili është i dedikuar për vendosjen e numrave nëpër objekte. Ndërsa, shumë tjetër do ta siguroj komuna në bazë të marrëveshjes së lartëcekur;
- Janë futur të dhënat në Sistemin ARIS, për një periudhë që e ka caktuar Agjensioni Kadastral;
- Kemi përfunduar vendosjen e 3000 numrave në objekte në qytetin e Vitisë dhe në fshatin Kabash.

Sfidat:

- Një ndër sfidat kryesore të kësaj drejtorie, është pamundësia e harmonizimit të kërkesave ndërtimore, sepse ekziston një dallim shumë i madh në mes të PZHK-së, planeve rregulluese dhe kërkesave të qytetarëve për ndërtim;
- Numër i vogël i personelit profesional. Mungon një ndërtimtar, një arkitekt, një specialist i GIS-it dhe një jurist i specializuar për fushën e ndërtimit, e që me ligjin mbi administrimin e pushtetit lokal, nuk na lejohet rritja e punëtorëve;
- Përfundimi i hartimit të PZHK-së, Hartës Zonale të komunës dhe ndryshimi i planeve tjera hapësinore. Raport i shpërndarjes së ndihmave COVID-19, prej datës 01.01.2021-30.06.2021

Të shpërndara						
Nr	Artikuj	Appeal International Australia	OKB	Komuna	Total	Kg
1	Miell thas 25/1	0	0	12	12	
2	Pako familjare	200	103		303	
3	Pako higjienike		103		103	

Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

I. Sektori i Financave

Raporti i punës për periudhën janar-qershor 2021

Gjatë kësaj periudhe janë kryer këto punë:

- Janë regjistruar 717 kupona të shpenzimeve në SIMFK (sistemi i menaxhimit të financave të Kosovës) përmes transferit me procedurë të prokurimit në vlerë prej 1,483,039.43 euro.
- Janë çertifikuar 717 pagesa përmes transferit me procedurë të prokurimit dhe aprovimit në vlerë prej 1,483,039.43 euro
- Gjatë kësaj periudhe në programin e Administratës Komunale dhe Arsimit parauniversitar janë dorëzuar në MAP – divizioni i pagave (puntorë të ri , largime dhe ndryshime), ndryshimet nga QKMF-ja, kopje të pranuar të cilat janë përfshirë në evidencën e përgjithshme.
- Është bërë barazimi i të hyrave vetanake në baza mujore në mes të hyrave të arkëtuara dhe të hyrave të paguara.
- Janë pranuar, evidentuar, protokolluar 772 fatura , kontrata, vendime, dhe të njëjtat janë dorëzuar për zotim dhe vijim të procedurës të mëtejme deri te ekzekutimi .
- Janë pranuar 164 raporte nga drejtorit që inkasojnë të hyra vetanake në vlerë nën 10 euro dhe janë bërë 36 deponime në bankë.

II . Sektori i buxhetit dhe thesari

Gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2021 janë kryer këto punë :

- Regjistrimi i obligimeve të pa paguara për periudhën janar - qershor 2021,
- Përgatitja e pasqyrave financiare për periudhën janar-mars 2021.
- Sistemimi i të gjithë punëtorëve në sistemin e pagave nëpër të gjitha programet, sipas planifikimit të buxhetit vitit 2021.
- Janë përgatitë të gjitha deklaratat e disponueshmërisë së mjeteve për pagesë të projekteve, duke u bazuar në planifikimin e buxhetit të vitit 2021.
- Dhënia e informacioneve për të gjithë udhëheqësit e programeve buxhetore, mbi gjendjen e rrjedhjes së parasë së gatshme, për tërë vitin 2021.
- Barazimi i regjistrave të pasurive mbi dhe nën 1.000 euro, të regjistruara në frebalanc/E pasuria si dhe regjistrimi në regjistra intern.

V. Projektet e investimeve kapitale për vitin 2021 të financuara nga buxheti i Komunës së Vitisë dhe buxheti i nivelit qendrorë.

1	Asfaltimi i rrugës Viti - Smirë, sipas dinamikës në përfundim	62,000.00
2	Asfaltimi i rrugëve rurale, në realizim e sipër nëpër vendbanime të Komunës	349,416,82
3	Rregullimi i filtrimit të ujit në Letnicë, në projektim	30,000.00
4	Rregullimi i kanalizimeve, në realizim të projektit	31,163.80
5	Rregullimi i rrugëve me zhavor, në realizim sipas dinamikës së projektit	201,390.75
6	Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik, në proces të realizimit	118,356.00
7	Rregullimi i hapësirave gjelbëruese –publike, në proces të realizimit sipas dinamikës	9,680.00
8	Rregullimi i fushave sportive në proces të realizimit sipas dinamikës së planifikuar	50,000.00
9	Rregullimi i lumenjve (kanaleve) dhe përrockave, në proces të realizimit	70,000.00
10	Ndërtimi i urave në Pozheran dhe Buzovik, në fazën e tenderimit	65,000.00
11	Fusha ndihmëse e futbollit në Pozheran, në fazën e përfundimit të projektit	135,00000
12	Riparime nëpër shkolla, në proces të realizimit, sipas projektit	27,827.00
13	Renovimi i ambulancave, në proces të prokurimit	97,493,00
14	Asfaltimi i rrugës Viti - Sllatinë e Ultë, në proces të tenderimit	200,000.00
15	Ndërtimi i ambulantes në fshatin Tërpezë, është përfunduar projekti	20.000,00
16	Furnizimi me aparatura dhe digjitalizim, në proces të projektimit	22,000.00
17	Rregullimi i hapësirave në QKMF, në proces të realizimit	8.000,00
18	Rregullimi i rrethojave të ambulancave, në fazën e realizimit	7.000,00
19	Rregullimi i nxemjes qendrore në ambulanta, në fazën e realizimit	15.000,00
20	Rregullimi i stadionit në Pozheran, në fazën e përfundimit të projektit	179,700.00
21	Rregullimi (asfaltimi) i rrugës alternative të Stubllës	447,000.00
22	Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në Qifllak, në përfundim	66,000.00
23	Ndërtimi i shkollës fillore në Pozheran, në proces të përfundimit	
24	Palestra e sporteve në Droresh (Punimi i konstruksionit të kulmit me kapriate), në proces të realizimit	
25	Renovimi i objektit për Muzeun e qytetit	31,600,00

23	Ndërtimi i shkollës fillore në Pozheran, në proces të përfundimit	
24	Palestra e sporteve në Drobesh (Punimi i konstruksionit të kulmit me kapriate), në proces të realizimit	
25	Renovimi i objektit për Muzeun e qytetit	31,600,00
26	Rregullimi i rrugës Viti-Korbliq-Kaçanik, në proces të prokurimit	
27	Rregullimi i rrugës së Mjakut dhe Dobelldehut, në proces të prokurimit	
28	Ndërtimi i infrastrukturës në parkun industrial Budrikë, në fazën përfundimtare	803,621.00
29	Ndërtimi i stadionit në Viti, është i përfunduar	450,000.00

Realizimi i këtyre projekteve gjatë vitit 2021, do të ndikoj drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

VI. Zyra për regjistrimin e bizneseve

- Gjatë periudhës janar- qershor 2021 janë regjistru 117 biznese të reja;
- Gjatë kësaj periudhe janë shuar 15 biznese;
- Numri i përgjithshëm i të punësuarve është 145 punëtorë.

Viti, Gusht 2021





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA			
Pranuar - Primljena Me/Dana		16-08-2021	
Nr. i organit	Numri/Eroj	Shtatjsh	Vlera
Org.broj		Prilog	Vrednost
01-035/02-572			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 40 paragrafi 2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, neni 13 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2018 për Transparencën në Komuna, neni 6 i Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, neni 35 paragrafi 2 pika d), të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryesuesi i Komunës së Vitisë, paraqet këtë

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2022

Neni 1

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë, i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që të shpallë në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2022.

Neni 2

Propozimi në diskutim publik i projekt planit të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2022 do të jepet në diskutim publik deri me: 01.09.2020. Propozimet, sugjerimet për plotësim ndryshim apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes së debatit publik, gjithashtu në formën të shkruar munde të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së dëgjimit publik në zyrën e sekretarisë së Kuvendit Komunal të Vitisë ndërtesa e komunës (ish tatimi në pronë), zyra nr. 2 si dhe në forme elektronike munde të dërgohen në emailin adresën fatlum.demiri@rks-gov.net, dokumenti gjendet në fep faqen e komunës së Vitisë, kk.rks-gov.net/viti.

Neni 3

Debatit publik do të mbahet me datën 17.09.2020, në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Qëllimi i këtij diskutimi publik është për të krijuar opinione pozitive për projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2021

Neni 6

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

DRAFT PLANI I PUNËSI KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2022

Gusht, 2021

PASQYRA E PLANIT

Parathënie	2
Përfundim	4
Janar	5
Shkurt	5
Mars	6
Prill	6
Maj	7
Qershor	8
Korrik	8
Gusht	9
Shtator	10
Tetor	10
Nëntor	11
Dhjetor	11

PARATHËNIE

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët, dhe funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore.

Kuvendi i Komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo Rregullores së punës;
- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligjit;
- Nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- Përgjegjësi të tjera që kërkojnë me ligj.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës, apo Kryetarit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifën dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Kuvendi i Komunës siguron kushte të punës për mbajtje të seancave të Kuvendit të Komunës, si dhe pjesëmarrje për qytetarë gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu iu krijon mundësi qytetarëve, që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Përveç këtyre akteve, Kuvendi i Komunës kryen edhe aktivitete të tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësi të saj, përfshirë edhe funksione tjera, detyra dhe përgjegjësi të padeleguara si:

- Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e Komunës;

- Miratimin e Planit zhvillimor komunal (PZHK), Planit zhvillimor urban (PZHU), dhe Planeve rregulluese urbane (PRRU), si dhe ndryshimin e tyre; dhe
- Themelimin e ndërmarrjeve publike të Komunës.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komitetit të caktuar të Kuvendit apo Kryetarit të Komunës dhe këtë delegim mund ta tërheqë në çdo kohë.

Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë është dokument i mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet tjera nënligjore. Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike, i cili planifikon etapat e realizimit të punëve dhe detyrave të Kuvendit të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti dhe aktet tjera nënligjore.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2021, ku Kuvendi i Komunës së Vitisë planifikon t'i mbaj 12 (dymbëdhjetë) seanca të rregullta, 6 (gjashtë) prej të cilave në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, në të cilat do të trajtohen të gjitha çështjet që janë në interes të Komunës dhe të qytetarëve të Vitisë, e të cilat janë të proceduara sipas akteve në fuqi:

- Cakton datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit sipas rregullores së punës së Kuvendit;
- Themelon Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete sipas ligjit;
- Funksionalizon komitetet e formuara këshillëdhënëse dhe planifikon raportimin e këtyre komiteve para Kuvendit së paku një herë në vit.
- Planifikon shqyrtimin e raporteve e rregullta të punës së Kryetarit të Komunës sipas ligjit;
- Inkorporon planin e tubimeve me qytetarë të Kryetarit të Komunës;
- Miraton buxhetin, planet investuese, planin vjetor të prokurimit, planin vjetor të punës së auditorit të brendshëm, planet rregullative etj.
- Miraton çështje tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas Statutit apo Rregullores së punës;
- Nxjerr rregullore të reja dhe bënë harmonizimin e rregulloreve ekzistuese me ligjet në fuqi;
- Inkorporon planin e Kryetarit për festa shtetërore e kombëtare;
- Mbikëqyrë, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e ekzekutivit.

PËRFUNDIM

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës, do të ndihmojë dhe lehtësojë punimet e mbledhjeve të Kuvendit. Duke iu ofruar anëtarëve të Kuvendit këtë plan, ata do të kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2022, e që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve.

Me planin e punës janë paraparë 12 seanca të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe seanca tjera përfshirë edhe seanca të jashtëzakonshme, siç parashihet me LVL-në dhe Statutin e Komunës. Ndërsa seanca solemne janë parapa 3, si: 17 Shkurti - Dita e Pavarësisë së Kosovës, 05 Maj - Dita e Dëshmorëve të Komunës së Vitisë, 14 Qershori - Dita e Çlirimit të Komunës së Vitisë.

Dinamika e planit të punës së Kuvendit të Komunës do të realizohet në bazë të orarit të mbledhjeve të Kuvendit të miratuar në mbledhjen e parë të Kuvendit në vitin 2022, që përfshin edhe orarin e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Për përmbushjen e Programit të punës, ekzekutivi ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të Kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe agjendës sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit të të gjitha aktiviteteve, sipas dinamikës të përcaktuar me këtë program, do të përkujdesen kryetari, kryesuesi i Kuvendit dhe Sekretaria e Kuvendit.

Realizimi i Programit të Punës së Kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Ekzekutivin e Komunës, e cila duhet t'i përmbahet planit të Kuvendit për vitin 2022.

Plani i punës së Kuvendit sipas dinamikës mujore përfshinë: emërtimin e aktit, propozuesin, afatin e dërgimit nga propozuesi, afatet e shqyrtimeve nga komitetet funksionale përgjegjëse për shqyrtim.

Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2022 do të plotësohet edhe me:

- Miratimin e iniciativave për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar;
- Propozime për debate dhe propozime përmbajtjesore;
- Propozime për raportime dhe informata;
- Peticione; dhe
- Pyetje të anëtarëve të Kuvendit.

Shtojcë: *Plani i punës sipas muajve*

Viti

Zyrtar i Lartë Profesional i KK-së

Fat Demiri
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit

Naim Pira
Naim Pira

PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2021
JANAR 2022

Nr	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Informatë për situatën ekonomike - financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës për vitin 2021 (Informata për Punën e Kryetarit të Komunës)	Kryetari i Komunës	Kryetari i Komunës	10.01.2022	KPF 16.01.2022	27.01.2022	
2.	Pasqyrat financiare për muajin Tetor - Dhjetor dhe Pasqyrat financiare për periudhën Janar - Dhjetor 2021	Drejtorja e Financave	Kryetari i Komunës	10.01.2022	KPF 16.01.2022	27.01.2022	
3.	Shqyrtimi i Planit vjetor të Auditorit të Brendshëm 2021	Zyra e auditorit	Kryetari i Komunës	10.01.2022	KPF 16.01.2022	27.01.2022	
4.	Miratimi i Planit Vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)	KKSB	Kryetari i Komunës	10.01.2022	KPF 16.01.2022	27.01.2022	
5.	Informata rreth planit vjetor të integritetit në Kuvendin Komunal	Ekzekutivi komunal	Kryetari i Komunës	10.01.2022	KPF 16.01.2022	27.01.2022	
6.	Shqyrtimi i progresit të adresimit të rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimit 2021	Drejtorja e Financave	Kryetari i Komunës	10.01.2022	KPF 16.01.2022	27.01.2022	
7.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi komunal	Kryetari i Komunës	10.01.2022	KPF 16.01.2022	27.01.2022	

PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2021
SHKURT 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Informate mbi përfundimin e gjysmëvjetorit të parë shkollor	DKA	Kryetari i Komunës	10.02.2022	KPF 17.02.2022	28.02.2022	17 shkurti Dita e pavarësisë
2.	Shqyrtimi i Planit të prokurimit për vitin 2022	Zyra e Prokurimit	Kryetari i Komunës	10.02.2022	KPF 17.02.2022	28.02.2022	

3.	Informatë mbi kontratat kornizë të Komunës së Vitisë	Drejtoria e shërbimeve publike	Kryetari i Komunës	10.02.2022	KPF 17.02.2022	28.02.2022	
4.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	10.02.2022	KPF 17.02.2022	28.02.2022	
5.	Informatë (Raport) nga Zyra e Personelit në Kuvendin Komunal për vitin 2021	Zyra e Personelit	Kryetari i Komunës	10.02.2022	KPF 17.02.2022	28.02.2022	

PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2021
MARS 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitete Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Bartja (riallokimi) i buxhetit të pasqepzuar nga viti i kaluar në vitin aktual	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	10.03.2022	KPF 22.03.2022	30.03.2022	
2.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi komunal	Kryetari i Komunës	10.03.2022	KPF 22.03.2022	30.03.2022	

PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2021
PRILL 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitete Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Pasqyrat financiare të Komunës për periudhën Janar – Mars 2022	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	10.04.2022	KPF 19.04.2022	29.04.2022	
2.	Informate mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimin e tyre	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	10.04.2022	KPF 19.04.2022	29.04.2022	

3.	Informate mbi përgatitjen e te mbjell urave pranverore	Drejtoria e Bujqësisë	Kryetari i Komunës	10.04.2022	KPF 19.04.2022	29.04.2022	
4.	Informate mbi Raportin e Përformancës	MAPL	Kryetari i Komunës	10.04.2022	KPF 19.04.2022	29.04.2022	
5.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	10.04.2022	KPF 19.04.2022	29.04.2022	

PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2021
MAJ 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Informate mbi përgatitjet për mirëmbajtjen e rrugëve ne sezonin veror	Drejtoria e shërbimeve publike	Kryetari i Komunës	10.05.2022	KPF 20.05.2022	29.05.2022	05 Maj-Dita e Dëshmorëve të Komunës së Vitisë
2.	Informate mbi Festivalin "Flakadani I Karadakut"	Drejtoria e Kulturës	Kryetari i Komunës	10.05.2022	KPF 20.05.2022	29.05.2022	
3.	Informate mbi punën e KKSB-se	KKSB	Kryetari i Komunës	10.05.2022	KPF 20.05.2022	29.05.2022	
4.	Informate mbi punën e komiteteve funksionale	Komitetet funksionale	Kryetari i Komunës	10.05.2022	KPF 20.05.2022	29.05.2022	
5.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	10.05.2022	KPF 20.05.2022	29.05.2022	

PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2021
QERSHOR 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2022-2024	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	10.06.2022	KPF 22.06.2022	30.06.2022	14 Qershor-Dita e Çlirimit të Komunës së Vitisë
2.	Rishikimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2021	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	10.06.2022	KPF 22.06.2022	30.06.2022	
3.	Shqyrtimi i raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së	KKSB	Kryetari i Komunës	10.06.2022	KPF 22.06.2022	30.06.2022	
4.	Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vitisë	Drejtoria e shërbimeve Publike	Kryetari i Komunës	10.06.2022	KPF 22.06.2022	30.06.2022	
5.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	10.06.2022	KPF 22.06.2022	30.06.2022	

PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2021
KORRIK 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Informatë për situatën ekonomike-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës janar-qershor 2022, (informata për punën e Kryetarit të komunës)	Zyra e Kryetarit	Kryetari i Komunës	10.07.2022	Jo ne KPF	28.07.2022	

2.	Pasqyrat financiare periudhën Janar– Qershor 2022	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	10.07.2022	KPF 20.07.2022	28.07.2022	
3.	Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën për vitin 2021	ZAP	Kryetari i Komunës	10.07.2022	KPF 20.07.2022	28.07.2022	
4.	Informate mbi realizimin e Planit të Prokurimit	Zyra e Prokurimit	Kryetari i Komunës	10.07.2022	KPF 20.07.2022	28.07.2022	
5.	Informate mbi përfundimin e vitit shkollor	Drejtoria e Arsimit	Kryetari i Komunës	10.07.2022	KPF 20.07.2022	28.07.2022	
6.	Fillimi i përgatitjes për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022	Zyra e Kuvendit	Kryetari i Komunës	10.07.2022	KPF 20.07.2022	28.07.2022	
7.	Fillimi i përgatitjes për hartimin e Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	10.07.2022	KPF 20.07.2022	28.07.2022	
8.	Fillimi i përgatitjes për hartimin e Rregullores për tatimin në pronë	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	10.07.2022	KPF 20.07.2022	28.07.2022	
9.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	10.07.2022	KPF 20.07.2021	28.07.2022	

PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2021
GUSHT 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraparak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				

PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2021
SHTATOR 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2022 dhe projektionet për vitin 2023-2024	Drejtoria e financave	Kryetari i Komunës	10.09.2022	KPF 21.09.2022	29.09.2022	
2.	Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022	Grupi punues	Kryetari i Komunës	10.09.2022	KPF 21.09.2022	29.09.2022	
3.	Informate mbi fillimin e vitit të ri shkollor	DKA	Kryetari i Komunës	10.09.2022	KPF 21.09.2022	29.09.2022	
4.	Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për tatimin në pronë	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	10.09.2022	KPF 21.09.2022	29.09.2022	
5.	shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa	Drejtoria e financave	Kryetari i Komunës	10.09.2022	KPF 21.09.2022	29.09.2022	
6.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	10.09.2022	KPF 21.09.2022	29.09.2022	
7.	Informate mbi përfundimin e fushatës së korrije-shirjeve	Drejtoria e Bujqësisë	Kryetari i Komunës	10.09.2022	KPF 21.09.2022	29.09.2022	

PLANI I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2021
TETOR 2022

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Pasqyrat financiare të Komunës për periudhën Janar– Shtator 2022	Drejtoria e Financave	Kryetari i Komunës	10.10.2022	KPF 21.10.2022	31.10.2022	
2.	Informate mbi realizimin e Planit të Prokurimit 2022	Zyra e Prokurimit	Kryetari i Komunës	10.10.2022	KPF 21.10.2022	31.10.2022	
3.	Informate mbi realizimin e projekteve investive kapitale janar-shtator 2022	Zyra e prokurimit	Kryetari i Komunës	10.10.2022	KPF 21.10.2022	31.10.2022	
4.	Informate mbi ndarjen e subvencioneve	Drejtoria e Kulturës	Kryetari i Komunës	10.10.2022	KPF 21.10.2022	31.10.2022	

5.	Informatë mbi implementimin e Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike në Komunën e Vitisë	Drejtoria e Urbanizmit	Kryetari i Komunës	10.10.2022	KPF 22.10.2022	31.10.2022	
6.	Informatë mbi implementimin e Planit për Mirëmbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike në Komunën e Vitisë	Drejtoria e Urbanizmit	Kryetari i Komunës	10.10.2022	KPF 22.10.2022	31.10.2022	
7.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	10.10.2022	KPF 22.10.2022	31.10.2022	

**PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2021
NËNTOR 2022**

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Hartuesi	Propozuesi				
1.	Informate mbi procesin e legalizimit të objekteve	Drejtoria e Urbanizmit	Kryetari i Komunës	10.11.2022	KPF 22.11.2022	30.11.2022	
2.	Informate e Drejtorisë së Bujqësisë mbi të mbjellat vjetore	Drejtoria e Bujqësisë	Kryetari i Komunës	10.11.2022	KPF 22.11.2022	30.11.2022	
3.	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	10.11.2022	KPF 22.11.2022	30.11.2022	

**PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2021
DHJETOR 2022**

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	Aktivitetet Afati kohor
		Harton	Propozon				
1.	Informate mbi realizimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022 dhe informatë mbi punën e komitetëve obligative	Sekretaria e kuvendit	Kryetari i Komunës	10.12.2022	KPF 22.12.2022	29.12.2022	

	dhe funksionale te kuvendit te komunës për vitin 2022								
2.	Shqyrtimi I raportit (informatës) rreth aktiviteteve të KKS-së	KKS	Kryetari i Komunës	10.12.2022	KPF 22.12.2022	29.12.2022			
3.	Shqyrtimi I propozim vendimeve dhe kërkesave nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi Komunal	Kryetari i Komunës	10.12.2022	KPF 22.12.2022	29.12.2022			